

RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	
EMËRTIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	Projektligj “Për një shtesë dhe disa ndryshime në ligjin nr. 9587, datë 20.7.2006 “Për mbrojtjen e biodiversitetit” i ndryshuar
MINISTRIA UDHËHEQËSE	Ministria e Mjedisit
FAZA E POLITIKËS/VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	Finale
BURIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	I brendshëm
DIREKTIVË/RREGULLORE E BE-së	Direktiva
PUBLIKIMET DHE STRATEGJITË E LIDHURA	VKM nr. 31, datë 20.01.2016 “Për miratimin e Dokumentit të Politikave Strategjike për Mbrojtjen e Biodiversitetit”
DATA E KONSULTIMIT PUBLIK	04.06.2026- 02.07.2026
DATA E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	07/08/2026
A E KA SHQYRTUAR KRYEMINISTRIA VLERËSIMIN E NDIKIMIT? NËSE PO, JEPNI DATËN E SHQYRTIMIT	Po, 20/06/2026
NUMRI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	2026 – MMj – Nr. 4
TE DHËNA KONTAKTI (EMRI, E-MAIL, NUMRI I TELEFONIT TË PERSONIT TË KONTAKTIT)	Klodiana Marika e-mail: klodiana.marika@turizmi.gov.al numri i telefonit: 0692092872
PJESA 1: PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE (Maksimumi 2 faqe) Biodiversiteti përbën një nga elementët themelorë të kapitalit natyror dhe ka një rol të rëndësishëm në sigurimin e shërbimeve të ekosistemeve, ruajtjen e ekuilibrave ekologjikë dhe mbështetjen e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe social. Ligji nr. 9587, datë 20.07.2006 “Për mbrojtjen e biodiversitetit”, i ndryshuar, ka krijuar bazën kryesore ligjore për ruajtjen dhe menaxhimin e biodiversitetit në Republikën e Shqipërisë. Megjithatë, zhvillimet në fushën e mbrojtjes së natyrës, detyrimet që burojnë nga procesi i integritetit evropian dhe nevoja për zbatim më efektiv të dispozitave ekzistuese kanë evidentuar nevojën për përmirësimin e mëtejshëm të këtij kuadri ligjor. Projektligji synon forcimin e kuadrit kombëtar për mbrojtjen e biodiversitetit përmes: • përafrimit më të plotë me acquis të Bashkimit Evropian në fushën e natyrës; • përmirësimin e mekanizmave të monitorimit dhe raportimit; • forcimin e masave për ruajtjen e habitateve dhe llojeve; • krijimin e një kuadri më të qartë për aksesin në burimet gjenetike dhe ndarjen e përfitimeve; • përmirësimin e menaxhimit të llojeve jo vendase dhe invazive. Ndërhyrja propozohet të realizohet përmes ndryshimit dhe plotësimit të ligjit ekzistues, si alternativa më proporcionale dhe efektive, duke shmangur krijimin e strukturave të reja administrative dhe duke përdorur mekanizmat institucionalë ekzistues.	
PËRKUFIZIMI I PROBLEMIT <i>Cili është problemi në shqyrtim dhe cilat janë shkaqet e tij? Pse është e nevojshme ndërhyrja qeverisë?</i>	

Shqipëria zotëron një pasuri të konsiderueshme biologjike, e cila përfshin një numër të lartë habitatesh natyrore, llojesh bimore dhe shtazore me rëndësi kombëtare dhe evropiane.

Kuadri ligjor aktual ka mundësuar ngritjen e bazës për mbrojtjen e biodiversitetit, përfshirë përcaktimin e masave për mbrojtjen e llojeve, habitateve dhe zonave me vlera natyrore.

Megjithatë, gjatë zbatimit të tij janë evidentuar disa nevoja për përmirësim, të lidhura kryesisht me zhvillimet e reja ndërkombëtare dhe evropiane në këtë fushë.

Problemi kryesor në shqyrtim lidhet me mungesën e përafrimit të plotë të kuadrit aktual ligjor dhe institucional për mbrojtjen e biodiversitetit me kërkesat e *acquis* të Bashkimit Evropian dhe standardet ndërkombëtare në këtë fushë. Kjo mungesë nuk përbën vetëm një boshllëk formal ligjor, por ndikon drejtpërdrejt në mënyrën se si monitorohet, administrohet, mbrohet dhe raportohet biodiversiteti në Republikën e Shqipërisë.

Problematikat kryesore të identifikuara janë:

a) Mungesa e një sistemi të plotë dhe të standardizuar për monitorimin dhe raportimin e biodiversitetit

Sistemi aktual i monitorimit dhe raportimit nuk siguron në mënyrë të plotë mbledhjen, përpunimin dhe administrimin e të dhënave të standardizuara për statusin e habitateve dhe llojeve. Të dhënat ekzistuese janë të shpërndara ndërmjet institucioneve të ndryshme dhe mungesa e një baze të konsoliduar të informacionit kufizon përdorimin efektiv të tyre për planifikim, vendimmarrje, monitorim dhe raportim.

Shkaqet e problemit:

- mungesa e metodologjive plotësisht të harmonizuara për monitorimin e habitateve dhe llojeve;
- mungesa e standardeve të unifikuara për mbledhjen dhe administrimin e të dhënave;
- shkëmbimi i kufizuar i informacionit ndërmjet institucioneve përgjegjëse.

Grupet e prekura:

- Ministria e Mjedisit;
- Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura;
- Agjencia Kombëtare e Mjedisit;
- institucionet kërkimore dhe akademike;
- organizatat e shoqërisë civile;
- publiku dhe grupet e interesit.

b) Boshllëqe në përafrimin e kuadrit ligjor me *acquis* të Bashkimit Evropian

Kuadri aktual ligjor nuk reflekton plotësisht kërkesat e Direktivës 92/43/KEE “Për ruajtjen e habitateve natyrore dhe të florës dhe faunës së egër” dhe Direktivës 2009/147/KE “Për ruajtjen e shpendëve të egër”. Këto boshllëqe lidhen me rregullimin e disa elementeve që kanë të bëjnë me statusin e ruajtjes së habitateve dhe llojeve, mbrojtjen strikte të llojeve, monitorimin dhe raportimin.

Shkaqet e problemit:

- zhvillimet e mëtejshme të *acquis* të BE-së pas miratimit të ligjit ekzistues;
- transpozimi jo i plotë i disa kërkesave evropiane;
- mungesa e dispozitave të detajuara për zbatimin praktik të disa mekanizmave.

Grupet e prekura:

- institucionet publike përgjegjëse për zbatimin e legjislacionit mjedisor;
- subjektet publike dhe private që zhvillojnë veprimtari me ndikim mbi biodiversitetin;

- institucionet përgjegjëse për procesin e integritetit evropian.

c) Mungesa e një kuadri të plotë për aksesin në burimet gjenetike dhe ndarjen e përfitimeve (ABS)

Kuadri aktual nuk siguron në mënyrë të plotë rregullimin e procedurave për aksesin në burimet gjenetike, kontrollin e përdoruesve dhe ndarjen e drejtë e të barabartë të përfitimeve nga përdorimi i tyre, duke kufizuar zbatimin efektiv të detyrimeve që burojnë nga Protokollin e Nagojës.

Shkaqet e problemit:

- mungesa e procedurave të detajuara administrative;
- mungesa e mekanizmave të kontrollit dhe verifikimit;
- përcaktimi jo i plotë i përgjegjësisë institucionale.

Grupet e prekura:

- institucionet publike përgjegjëse;
- institucionet kërkimore dhe universitetet;
- subjektet që përdorin burime gjenetike;
- komunitetet lokale.

d) Mangësi në menaxhimin e llojeve jo vendase dhe invazive

Kuadri aktual nuk përcakton në mënyrë të plotë mekanizmat për parandalimin, identifikimin e hershëm, monitorimin dhe kontrollin e llojeve jo vendase dhe invazive. Kjo rrit rrezikun e ndikimeve negative mbi llojet vendase, habitatet natyrore dhe funksionimin e ekosistemeve.

Shkaqet e problemit:

- mungesa e procedurave të detajuara për menaxhimin e llojeve invazive;
- mungesa e sistemeve të integruara të monitorimit;
- koordinimi jo gjithmonë efektiv ndërmjet institucioneve përgjegjëse.

Grupet e prekura:

- institucionet përgjegjëse për mjedisin;
- njësitë e vetëqeverisjes vendore;
- sektorët e bujqësisë, pylltarisë dhe peshkimit;
- komunitetet lokale
- organizatat e shoqërisë civile.

OBJEKTIVAT

Cilat janë objektivat dhe efektet e synuara të propozimit?

Objektivi i përgjithshëm i ndërhyrjes është përmirësimi i kuadrit ligjor dhe institucional për mbrojtjen dhe menaxhimin e biodiversitetit, nëpërmjet përafrimit me acquis të Bashkimit Evropian dhe forcimit të mekanizmave për ruajtjen, monitorimin dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve biologjike.

Nr.	Objektivi i matshëm	Vlera bazë – 2026	Targeti i synuar	Afati	Burimi i verifikimit
1	Kuadrit ligjor me acquis të BE-së për biodiversitetin i përafuar	0% e dispozitave të reja të projektligjit janë në fuqi para miratimit.	100% e dispozitave dhe akteve zbatuese të planifikuara në tabelën e përputhshmërisë të miratuara.	2027	Tabela e përputhshmërisë; ligji dhe aktet nënligjore.
2	Monitorimi dhe raportimi kombëtar i standardizuar.	0 metodologji e unifikuar sipas kuadrit të ri; të dhënat janë të fragmentuara.	Të paktën 1 metodologji; 1 përditësim i bazës së të dhënave dhe 1 raport kombëtar çdo vit.	2027	Aktet miratuese; sistemi i informacionit; raportet AKM/AKZM.
3	Habitatet natyrore prioritare të monitoruara.	0 program kombëtar i integruar sipas kuadrit të ri.	100% e habitateve prioritare në programin vjetor dhe 1 raport statusi çdo vit.	2027	Programet dhe raportet e monitorimit.

4	Llojet prioritare të monitoruara dhe mbrojtura.	0 program kombëtar i standardizuar sipas kuadrit të ri.	100% e llojeve prioritare në programin vjetor dhe 1 raport vjetor.	2027	Listat prioritare; programet dhe raportet vjetore.
5	Sistemit ABS funksional	0 regjistër operacional dhe 0 procedurë standarde sipas kuadrit të ri.	1 regjistër dhe 1 procedurë funksionale; 100% e kërkesave dhe autorizimeve të regjistruhen.	2027	Regjistri ABS; autorizimet; raportet.
6	Ndarja e drejtë dhe e barabartë e përfitimeve.	0 model standard i miratuar.	1 model standard; 100% e autorizimeve përkatëse me kushte të dokumentuara.	2027	Modelet, marrëveshjet dhe autorizimet ABS.
7					
8					

- Forcimi i koordinimit institucional në fushën e biodiversitetit, duke siguruar qartësi të roleve dhe përgjegjësi ndërmjet institucioneve kompetente, përmirësim të shkëmbimit të informacionit dhe reduktim të mbivendosjeve institucionale, brenda vitit 2027.

OPSIONET E POLITIKAVE

Cilat janë opsionet kryesore të politikave, duke përfshirë mënyrat ndaj rregullimit? Duhet të bëni krahasimin e avantazheve/përfitimeve kryesore dhe të dizavantazheve/kostove të opsioneve të mundshme. Duhet të përcaktoni detajet në lidhje me opsionin e preferuar.

Për adresimin e problemeve të identifikuar janë analizuar alternativat e mëposhtme.

Opsioni 0 – Mosndërhyrja (status quo)

Ky opsion nënkupton ruajtjen e kuadrit ekzistues ligjor pa ndryshime.

Përfitimet:

- shmang kostot administrative të ndryshimeve ligjore;
- nuk kërkon përshtatje të menjëhershme institucionale;
- ruan vazhdimësinë e praktikave ekzistuese.

Kufizimet:

Ky opsion nuk adreson:

- nuk adreson boshllëqet aktuale në monitorim, raportim dhe koordinim institucional;
- nuk siguron përafrimin e plotë me acquis të Bashkimit Evropian;
- nuk trajton në mënyrë të plotë çështjet që lidhen me aksesin në burimet gjenetike dhe ndarjen e përfitimeve (ABS);
- nuk adreson në mënyrë efektive menaxhimin e llojeve jo vendase dhe invazive..

Për këtë arsye, ky opsion nuk konsiderohet i përshtatshëm.

Opsioni 1 – Opsioni jorregullator

Ky opsion parashikon përmirësimin e zbatimit të kuadrit ekzistues përmes masave administrative dhe institucionale, pa ndryshuar kuadrin ligjor. Masat mund të përfshijnë përmirësimin e koordinimit ndër-institucional, hartimin e udhëzimeve teknike, forcimin e kapaciteteve nëpërmjet trajnimeve, përmirësimin e praktikave të monitorimit dhe raportimit, si dhe rritjen e ndërgjegjësimit të aktorëve të përfshirë.

Avantazhet:

- mund të zbatohet në një periudhë më të shkurtër kohore;
- kërkon kosto më të ulëta administrative krahasuar me ndërhyrjet rregullatore;
- përmirëson zbatimin praktik të dispozitave ekzistuese;
- mund të forcojë kapacitetet institucionale.

Disavantazhet:

- nuk adreson boshllëqet që kërkojnë ndryshim ligjor;
- nuk siguron përafrimin e plotë me acquis të BE-së;
- nuk krijon bazë ligjore për rregullimin e plotë të aksesit në burimet gjenetike dhe ndarjen e përfitimeve;

- nuk mund të përcaktojë kompetenca apo detyrime të reja institucionale.

Për këtë arsye, ky opcion vlerësohet i dobishëm për përmirësimin e zbatimit, por i pamjaftueshëm për zgjidhjen e plotë të problemeve të identifikuara.

Opsioni 2 – Ndërhyrje të kufizuara përmes akteve nënligjore dhe masave administrative

Ky opcion parashikon përmirësimin e disa aspekteve të zbatimit përmes akteve nënligjore, procedurave dhe udhëzimeve teknike, pa ndryshuar ligjin bazë.

Avantazhet:

- mundëson rregullim më të detajuar të procedurave teknike;
- kërkon më pak kohë sesa ndryshimi i ligjit;
- mund të përmirësojë zbatimin praktik të dispozitave ekzistuese.

Disavantazhet:

- nuk mund të tejkalojë kufizimet e ligjit ekzistues;
- nuk mund të krijojë kompetenca ose detyrime të reja që kërkojnë bazë ligjore;
- nuk është i mjaftueshëm për adresimin e boshllëqeve kryesore që lidhen me përafrimin me acquis të BE-së, ABS-in dhe menaxhimin e llojeve invazive.

Opsioni 3 – Amendimi i ligjit ekzistues (Opsioni i preferuar)

Ky opcion parashikon ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 9587/2006 “Për mbrojtjen e biodiversitetit”, me qëllim adresimin e boshllëqeve ligjore dhe institucionale të identifikuara.

Ndërhyrja do të synojë:

- përafrimin më të plotë me acquis të Bashkimit Evropian;
- forcimin e sistemit të monitorimit dhe raportimit të biodiversitetit;
- përmirësimin e kuadrit për aksesin në burimet gjenetike dhe ndarjen e përfitimeve;
- përmirësimin e menaxhimit të llojeve jo vendase dhe invazive;
- qartësimin e roleve dhe përgjegjësiwe institucionale.

Avantazhet:

- adreson drejtpërdrejt problematikat që kërkojnë bazë ligjore;
- mundëson përafrim më të plotë me acquis të BE-së;
- përmirëson mekanizmat e monitorimit, raportimit dhe menaxhimit të biodiversitetit;
- siguron qartësi më të madhe institucionale;
- shmang hartimin e një kuadri krejtësisht të ri ligjor dhe përdor strukturat ekzistuese.

Disavantazhet:

- kërkon ndjekjen e procedurës ligjore për miratim;
- kërkon përshtatjen e praktikave ekzistuese pas hyrjes në fuqi;
- mund të kërkojë trajnime dhe forcim gradual të kapaciteteve institucionale.

Opsioni 4 – Hartimi i një ligji të ri për biodiversitetin

Ky opcion do të zëvendësonte ligjin aktual me një kuadër të ri tërësor.

Përfitimet:

- krijon mundësi për riorganizim të plotë të kuadrit ligjor;
- mund të integrojë në mënyrë gjithëpërfshirëse kërkesat e reja kombëtare dhe evropiane;
- mund të shmangë fragmentimin e dispozitave ekzistuese.

Kufizimet:

- proces më i gjatë;
- kosto më të larta administrative;

- rrezik për krijimin e boshllëqeve gjatë tranzicionit.

ANALIZA E NDIKIMEVE

Cilat janë ndikimet e opsionit të preferuar? Kjo duhet të përfshijë ndikimet me vlerë monetare të përcaktuar dhe ndikimet pa vlerë monetare të përcaktuar mbi buxhetin dhe bizneset.

Vlerësimi i ndikimeve të projektligjit është kryer duke analizuar efektet e pritshme që ndërhyrja ligjore do të ketë në:

- mjedis dhe biodiversitet;
- ekonomi dhe përdorim të qëndrueshëm të burimeve natyrore;
- buxhetin e shtetit;
- administratën publike;
- biznesin dhe subjektet e interesuara;
- shoqërinë;
- procesin e integritetit evropian.

Duke qenë se projektligji synon kryesisht forcimin e kuadrit ligjor dhe institucional, ndikimet kryesore të pritshme janë afatgjata dhe lidhen me përmirësimin e menaxhimit të biodiversitetit dhe përmbushjen e detyrimeve kombëtare dhe ndërkombëtare.

Ndikimi në mjedis dhe biodiversitet

Ky është ndikimi kryesor i ndërhyrjes dhe pritet të jetë pozitiv.

Projektligji do të kontribuojë në përmirësimin e mbrojtjes së biodiversitetit përmes:

a) Përmirësimin të ruajtjes së habitateve natyrore

Ndërhyrja ligjore synon forcimin e masave për:

- ruajtjen e habitateve me rëndësi kombëtare dhe evropiane;
- parandalimin e degradimit të habitateve;
- ruajtjen e funksioneve ekologjike të ekosistemeve;
- përmirësimin e lidhshmërisë ekologjike.

Kjo do të kontribuojë në ruajtjen e proceseve natyrore dhe në përmirësimin e statusit të ruajtjes së habitateve.

b) Përmirësimin të mbrojtjes së llojeve të egra

Projektligji forcon bazën ligjore për:

- mbrojtjen e llojeve të rrezikuara;
- ruajtjen e popullatave të llojeve vendase;
- përmirësimin e masave parandaluese ndaj presioneve antropogjene.

Ndikimi i pritshëm është ulja e rrezikut të humbjes së biodiversitetit dhe përmirësimi i masave të konservimit.

c) Përmirësimin i monitorimit të biodiversitetit

Forcimi i sistemit të monitorimit do të mundësojë:

- marrjen e vendimeve bazuar në të dhëna;
- identifikimin në kohë të ndryshimeve në statusin e habitateve dhe llojeve;
- përmirësimin e raportimit kombëtar dhe ndërkombëtar.

d) Menaxhimi i llojeve jo vendase dhe invazive

Projektligji krijon një bazë më të qartë për:

- parandalimin e futjes së llojeve invazive;
- kontrollin e përhapjes së tyre;
- marrjen e masave të menaxhimit.

Kjo do të reduktojë presionin mbi ekosistemet dhe llojet vendase.

Ndikimi ekonomik

Biodiversiteti siguron shërbime të rëndësishme të ekosistemit që mbështesin sektorë të ndryshëm ekonomikë, përfshirë:

- bujqësinë;

- pyjet;
- turizmin natyror;
- përdorimin tradicional të burimeve natyrore.

Projektligji pritet të ketë ndikim pozitiv afatgjatë përmes:

- ruajtjes së kapitalit natyror;
- reduktimit të degradimit të burimeve natyrore;
- nxitjes së përdorimit të qëndrueshëm të burimeve biologjike.

Një kuadër më i qartë ligjor krijon gjithashtu siguri më të madhe për aktivitetet që lidhen me përdorimin e burimeve biologjike dhe gjenetike.

Ndikimi në biznes

Projektligji nuk synon vendosjen e kufizimeve të panevojshme administrative ndaj biznesit.

Ndikimet kryesore lidhen me subjektet që:

- përdorin burime biologjike;
- kryejnë kërkime mbi burimet gjenetike;
- përdorin materiale biologjike për qëllime ekonomike.

Në këtë drejtim, projektligji synon:

- qartësimin e procedurave;
- rritjen e transparencës;
- garantimin e përdorimit të ligjshëm të burimeve.

Në afat të gjatë, një kuadër i qartë ligjor redukton pasiguritë dhe krijon kushte më të mira për zhvillim të qëndrueshëm.

Ndikimi financiar në buxhetin e shtetit

Projektligji nuk parashikon:

- krijimin e institucioneve të reja;
- krijimin e strukturave të reja administrative;
- rritje të drejtpërdrejtë të shpenzimeve publike.

Zbatimi do të mbështetet në kapacitetet ekzistuese të:

- Ministrisë përgjegjëse për mjedisin;
- Agjencisë Kombëtare të Mjedisit;
- Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura;
- institucioneve të tjera kompetente.

Megjithatë, mund të kërkohen burime për:

- trajnimin e stafit;
- përmirësimin e sistemeve të informacionit;
- forcimin e monitorimit.

Këto nevoja konsiderohen pjesë e zhvillimit normal të kapaciteteve institucionale dhe mund të mbështeten edhe nga programet e asistencës së BE-së dhe donatorëve.

Ndikimi administrativ

Ndikimi administrativ pritet të jetë pozitiv.

Projektligji synon:

- qartësimin e kompetencave;
- përmirësimin e koordinimit institucional;
- rritjen e efektivitetit të raportimit;
- shmangien e mbivendosjeve institucionale.

Nuk krijohet barrë e re administrative e konsiderueshme, pasi funksionet kryesore do të realizohen nga strukturat ekzistuese.

Ndikimi social

Ndikimet sociale lidhen me:

- ruajtjen e burimeve natyrore që mbështesin komunitetet lokale;
- rritjen e ndërgjegjësimit për vlerat e biodiversitetit;
- përmirësimin e aksesit në informacion mjedisor.

Menaxhimi më i mirë i biodiversitetit kontribuon në garantimin e përfitimeve afatgjata për komunitetet që varen nga burimet natyrore.

Ndikimi në procesin e integritetit evropian

Projektligji ka lidhje të drejtpërdrejtë me detyrimet e Shqipërisë në kuadër të Kapitullit 27 “Mjedisi dhe Ndryshimet Klimatike”.

Ai kontribuon në:

- përafrimin e legjislacionit kombëtar me acquis;
- forcimin e kapaciteteve të zbatimit;
- përmirësimin e raportimit;
- përmbushjen e detyrimeve nga Direktiva e Habitave dhe Direktiva e Shpendëve.

ARSYETIMI I OPSIONIT TË PREFERUAR

Shpjegoni arsyet për zgjedhjen e opsionit të preferuar. Ju lutemi jepni nëse është e mundur koston dhe përfitimin me vlerë të përcaktuar monetare.

Pas analizës së alternativave të mundshme, Opsioni 3 konsiderohet alternativa më e përshtatshme, pasi adreson në mënyrë të plotë problematikat e identifikuara dhe garanton përmbushjen e objektivave të projektligjit.

Ky opsion siguron:

- harmonizimin e kuadrit kombëtar me kërkesat e BE-së;
- forcimin e dispozitave për mbrojtjen e habitave dhe llojeve;
- krijimin e mekanizmave funksionalë për monitorim dhe raportim;
- vendosjen e bazës ligjore për zbatimin e Protokollit të Nagojës;
- përdorimin e kapaciteteve ekzistuese institucionale pa krijuar kosto të panevojshme.

Ndikimet pozitive të pritshme lidhen veçanërisht me përmirësimin e menaxhimit të biodiversitetit, reduktimin e rrezikut nga llojet invazive dhe rritjen e efektivitetit të masave të konservimit.

Në aspektin institucional, ndryshimet do të mundësojnë një ndarje më të qartë të përgjegjësi ndërmjet institucioneve dhe një sistem më të qëndrueshëm raportimi.

Në aspektin socio-ekonomik, ruajtja e shërbimeve të ekosistemit do të sjellë përfitime afatgjata për komunitetet lokale, zhvillimin e turizmit të natyrës dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore.

Në aspektin institucional, ndryshimet ligjore do të forcojnë kapacitetet e institucioneve përgjegjëse për mbrojtjen e biodiversitetit, duke mundësuar një sistem më të qëndrueshëm të monitorimit dhe raportimit periodik në përputhje me kërkesat e Bashkimit Evropian. Përmirësimi i qartësisë në ndarjen e përgjegjësi ndërmjet Ministrisë së Mjedisit, Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Njësitë e Qeverisjes Vendore, Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, dhe institucioneve kërkimore shkencore do të rrisë efikasitetin institucional dhe bashkëpunimin ndërsektorial në menaxhimin e biodiversitetit.

N

ndikimet shoqërore dhe ekonomike janë gjithashtu pozitive. Ruajtja shërbimeve të ekosistemit dhe qëndrueshmëria e tyre do të sjellë përfitime afatgjata për komunitetet lokale dhe ekonominë kombëtare, përmes zhvillimit të turizmit natyror, mbështetjes së bujqësisë së qëndrueshme dhe reduktimit të dëmeve nga degradimi i tokës apo erozioni. Për më tepër, zbatimi i suksesshëm i këtyre masave do të ndikojë në përmirësimin e imazhit ndërkombëtar të Shqipërisë dhe në forcimin e

kredibilitetit të saj në procesin e integritetit evropian, duke dëshmuar përkushtim ndaj mbrojtjes së biodiversitetit dhe zbatimit të standardeve të BE-së në fushën e mjedisit.

Kostoja e përlogaritur në total e opsionit të preferuar mbi buxhetin e shtetit gjatë periudhës 3-vjeçare menjëherë pas miratimit të ligjit (kostoja në total në lek, çmimet aktuale, në terma nominalë):

Viti 1	Viti 2	Viti 3
3,746,000	3,446,000	2,446,000

KONSULTIMI

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9587, datë 20.7.2006 “Për mbrojtjen e biodiversitetit” së bashku me dokumentacionin shoqërues (Raportin e VN dhe Relacion shpjegues) është publikuar për konsultim publik në Regjistrin elektronik të Konsultimit Publik në ëëbsite <http://www.konsultimipublik.gov.al/>, si dhe <http://www.mjedisi.gov.al> në datën 04.06.2026. Projektligji ka qëndruar i publikuar për konsultim publik deri më datë 02.07.2026. Gjatë periudhës së konsultimit publik janë paraqitur komente dhe sugjerime nga grupet e interesit. Këto komente janë shqyrtuar, por nuk janë marrë në konsideratë për reflektim në projektligj, pasi nuk kishin lidhje të drejtpërdrejtë me objektin e tij. Për këtë arsye, procesi i konsultimit publik nuk solli ndryshime në përmbajtjen e projektligjit.

ZBATIMI DHE MONITORIMI

Si do të organizohen zbatimi dhe monitorimi?

Zbatimi dhe monitorimi i ligjit do të realizohen në përputhje me dispozitat e ligjit për mbrojtjen e biodiversitetit dhe aktet nënligjore të miratuara në zbatim të tij.

Institucionet përgjegjëse për zbatimin dhe monitorimin do të jenë:

- Ministria përgjegjëse për mjedisin;
- Agjencia Kombëtare e Mjedisit;
- Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura;
- Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore;
- institucione të tjera kompetente sipas fushës së përgjegjësisë.

Monitorimi do të bazohet në mbledhjen sistematike të të dhënave, raportimin periodik dhe bashkëpunimin ndërinstitucional, me qëllim sigurimin e zbatimit efektiv të kërkesave të reja ligjore dhe përmbushjen e detyrimeve kombëtare dhe ndërkombëtare.

PJESA 2: BAZA KRYESORE E ANALIZËS DHE E PROVAVE

Historik

- *Jepni kontekstin e politikës*

Kuadri ligjor kryesor në fushën e mbrojtjes së biodiversitetit përbëhet nga ligji nr. 9587, datë 20.07.2006 “Për mbrojtjen e biodiversitetit”, i ndryshuar.

Ky ligj përcakton parimet, rregullat dhe instrumentet kryesore për ruajtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të diversitetit biologjik në Republikën e Shqipërisë, duke përfshirë mbrojtjen e habitateve natyrore, llojeve të florës dhe faunës së egër, ekosistemeve dhe elementëve të biodiversitetit me rëndësi kombëtare dhe ndërkombëtare.

Ligji nr. 9587/2006 ka pësuar ndryshime dhe plotësime ndër vite, të cilat kanë synuar përshtatjen e kuadrit ligjor me zhvillimet e reja në fushën e mbrojtjes së natyrës, forcimin e mekanizmave të zbatimit dhe përafrimin gradual me acquis të Bashkimit Evropian.

Ndryshimet ligjore kanë synuar kryesisht:

- forcimin e masave për mbrojtjen e habitateve dhe llojeve të egra;
- përmirësimin e mekanizmave të monitorimit dhe raportimit të biodiversitetit;
- qartësimin e përgjegjësiwe institucionale për zbatimin e dispozitave ligjore;
- përafrimin me kërkesat e Direktivës 92/43/KEE “Për ruajtjen e habitateve natyrore dhe të florës dhe faunës së egër” dhe Direktivës 2009/147/KE “Për ruajtjen e shpendëve të egër”;
- krijimin e bazës ligjore për adresimin e çështjeve të reja në fushën e biodiversitetit, përfshirë aksesin në burimet gjenetike dhe ndarjen e drejtë dhe të barabartë të përfitimeve që rrjedhin nga përdorimi i tyre.

Ndryshimet e kuadrit ligjor janë ndërmarrë për të adresuar nevojat e evidentuara gjatë zbatimit të legjislacionit ekzistues, për të përmirësuar efektivitetin e masave të mbrojtjes së biodiversitetit dhe për të garantuar përputhshmërinë me detyrimet ndërkombëtare dhe procesin e integritetit evropian.

Kuadri rregullator plotësohet nga aktet nënligjore në fuqi, të miratuara në zbatim të ligjit nr. 9587/2006 dhe legjislacionit të lidhur me të, të cilat rregullojnë aspekte të ndryshme të zbatimit të tij, përfshirë:

- aktet nënligjore për përcaktimin dhe administrimin e zonave të mbrojtura, të cilat rregullojnë procedurat për shpalljen, kategorizimin, menaxhimin dhe monitorimin e zonave me vlera të larta natyrore;
- aktet nënligjore për miratimin e listave të llojeve të mbrojtura të florës dhe faunës së egër, të cilat përcaktojnë regjimin e mbrojtjes për llojet me rëndësi kombëtare dhe ndërkombëtare;
- aktet nënligjore për monitorimin dhe raportimin e biodiversitetit, të cilat përcaktojnë procedurat dhe kërkesat për mbledhjen, administrimin dhe raportimin e të dhënave;
- aktet nënligjore që lidhen me administrimin e habitateve dhe ekosistemeve me vlera të veçanta natyrore.

Kuadri ligjor për mbrojtjen e biodiversitetit lidhet gjithashtu me legjislacionin për zonat e mbrojtura, mbrojtjen e faunës së egër, gjuetinë, pyjet, vlerësimin e ndikimit në mjedis, vlerësimin strategjik mjedisor, inspektimin mjedisor dhe përgjegjësinë për dëmet në mjedis.

Në nivel strategjik, kuadri rregullator mbështetet nga Dokumenti i Politikave Strategjike për Mbrojtjen e Biodiversitetit, miratuar me VKM nr. 31, datë 20.01.2016, si dhe nga Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022–2030, miratuar me VKM nr. 88, datë 22.02.2023, e cila përcakton objektivat e Shqipërisë për integrimin evropian, mbrojtjen e mjedisit dhe përafrimin me Kapitullin 27 “Mjedisi dhe Ndryshimet Klimatike”.

Në vijim të zhvillimit të kuadrit ligjor kombëtar dhe angazhimeve ndërkombëtare të Shqipërisë, përfshirë Konventën për Diversitetin Biologjik dhe procesin e integritetit evropian, legjislacioni për biodiversitetin është zhvilluar gradualisht me qëllim forcimin e masave për ruajtjen e natyrës dhe harmonizimin me standardet ndërkombëtare dhe evropiane në këtë fushë.

Megjithatë, elementët që lidhen me boshllëqet e kuadrit aktual ligjor, problematikat e zbatimit dhe nevojën për ndërhyrje rregullatore trajtohen në mënyrë të veçantë në rubrikat përkatëse të analizës së problemit dhe arsyesimit të ndërhyrjes.

Problemi në shqyrtim

- *Përshkruani natyrën e problemit.*
- *Identifikoni shkaqet e problemit.*
- *Përshkruani shtrirjen e problemit.*
- *Identifikoni grupet e prekura nga ky problem - qeveria / biznesi / shoqëria civile / qytetarët.*
- *Vlerësoni nëse problemi mund të trajtohet ose jo përmes një ndryshimi të politikave.*

Zbatimi i ligjit ekzistues ka mundësuar ngritjen e një baze institucionale dhe rregullatore për mbrojtjen e natyrës, përfshirë përcaktimin e zonave të mbrojtura, masave për ruajtjen e llojeve dhe mekanizmave fillestarë të monitorimit. Megjithatë, zhvillimet e reja në politikat mjedisore të BE-së, rritja e kërkesave për raportim të standardizuar, si dhe nevoja për menaxhim më të integruar të biodiversitetit kanë nxjerrë në pah boshllëqe në kuadrin ekzistues.

Megjithëse Shqipëria ka zhvilluar një kuadër ligjor dhe institucional për mbrojtjen e biodiversitetit dhe ka krijuar një rrjet të gjerë zonash të mbrojtura, ekziston nevoja për forcimin e mëtejshëm të mekanizmave që garantojnë ruajtjen efektive të specieve, habitateve dhe ekosistemeve. Sipas të dhënave të INSTAT për vitin 2024, rrjeti i zonave të mbrojtura përbëhej nga 777 zona, me një sipërfaqe totale prej 624 611 hektarësh. Në të njëjtin vit, fondi pyjor dhe kullësor mbulonte 1 731 891 hektarë, ose 60,2% të sipërfaqes së vendit. Këta tregues evidentojnë rëndësinë e biodiversitetit dhe të ekosistemeve natyrore në territorin e Shqipërisë, por në vetvete nuk mjaftojnë për të vlerësuar gjendjen dhe tendencat e biodiversitetit.¹

Problemi kryesor në shqyrtim lidhet **me mungesën e përafrimit të plotë** të kuadrit aktual ligjor dhe institucional për mbrojtjen e biodiversitetit me kërkesat e acquis të Bashkimit Evropian dhe me standardet ndërkombëtare në këtë fushë. Kjo mungesë përafrimi nuk përbën vetëm një boshllëk formal ligjor, por sjell pasoja konkrete në mënyrën se si monitorohet, administrohet, mbrohet dhe raportohet biodiversiteti në Republikën e Shqipërisë.

Në praktikë, kuadri aktual ka krijuar bazën fillestare për mbrojtjen e habitateve, llojeve të egra dhe ekosistemeve, por nuk garanton ende një sistem të plotë, të standardizuar dhe funksional për përmbushjen e kërkesave bashkëkohore të mbrojtjes së natyrës. Problematikat kryesore që rrjedhin nga kjo situatë janë si më poshtë:

1.Problemet në monitorimin dhe raportimin e standardizuar të biodiversitetit

Një problem i rëndësishëm lidhet me nevojën për përmirësimin e monitorimit dhe vlerësimit të efektivitetit të masave të mbrojtjes. Raporti i Gjashtë Kombëtar për Konventën për Diversitetin Biologjik evidenton se vlerësimi i efektivitetit të menaxhimit të zonave të mbrojtura është një element i rëndësishëm për përmirësimin e administrimit të tyre. Në kuadër të këtij procesi, efektiviteti i menaxhimit është vlerësuar për 51 zona të mbrojtura, duke treguar nevojën për forcimin e kapaciteteve të menaxhimit, sigurisë financiare dhe mjeteve të nevojshme për administrimin e zonave të mbrojtura.²

Gjithashtu, të dhënat statistikore të disponueshme për biodiversitetin mbështeten në të dhëna administrative dhe përfshijnë, ndër të tjera, informacion mbi zonat e mbrojtura sipas kategorive

¹ INSTAT – Forestry and Biodiversity Statistics, 2024

² Sixth National Report of Albania to the Convention on Biological Diversity

dhe speciet e mbrojtura dhe të kërcënuara të florës dhe faunës. Kjo e bën të nevojshme forcimin e sistemeve të monitorimit dhe të mbledhjes së të dhënave për të siguruar informacion më të plotë dhe të krahasueshëm në kohë mbi gjendjen e specieve, habitateve dhe ekosistemeve dhe për të mbështetur vendimmarrjen e bazuar në evidenca.³

Kuadri aktual për monitorimin dhe raportimin e biodiversitetit në Shqipëri karakterizohet nga mungesa e një sistemi të integruar, të standardizuar dhe të harmonizuar me metodologjitë e Bashkimit Evropian. Mbledhja e të dhënave për habitatet natyrore dhe llojet e egra kryhet në mënyrë të fragmentuar, shpesh në kuadër të projekteve të veçanta, studimeve të kufizuara ose përmes metodologjive të ndryshme të përdorura nga institucione të ndryshme.

Kjo mënyrë e fragmentuar e mbledhjes dhe administrimit të të dhënave vështirëson krahasueshmërinë, besueshmërinë dhe përdorimin e informacionit për vendimmarrje. Për pasojë, institucionet përgjegjëse kanë vështirësi në vlerësimin e saktë të gjendjes së ruajtjes së habitateve dhe llojeve, në monitorimin e tendencave afatgjata dhe në përgatitjen e raportimeve të plota sipas kërkesave të acquis të Bashkimit Evropian.⁴

Mungesa e të dhënave të qëndrueshme dhe të standardizuara ndikon gjithashtu në cilësinë e politikëbërjes, pasi masat për mbrojtjen e biodiversitetit nuk mund të bazohen gjithmonë në evidenca të plota dhe të përditësuara.

2. Mungesa e përafrimit të plotë me Direktivën e Habitave dhe Direktivën e Shpendëve

Kuadri aktual ligjor nuk siguron ende përafrim të plotë me kërkesat e Direktivës 92/43/KEE “Për ruajtjen e habitateve natyrore dhe të florës dhe faunës së egër” dhe Direktivës 2009/147/KE “Për ruajtjen e shpendëve të egër”. Këto direktiva kërkojnë rregulla të qarta për mbrojtjen e habitateve natyrore, ruajtjen e llojeve të egra, mbrojtjen strikte të llojeve të caktuara, monitorimin e statusit të tyre të konservimit dhe raportimin periodik mbi gjendjen e biodiversitetit.

Në praktikë, mungesa e përafrimit të plotë krijon paqartësi në mënyrën se si përcaktohen, zbatohen dhe monitorohen masat për ruajtjen e habitateve dhe llojeve. Kjo mund të kufizojë efektivitetin e mbrojtjes ligjore, të vështirësojë zbatimin e standardeve të BE-së dhe të ndikojë në përmbushjen e detyrimeve të Shqipërisë në kuadër të Kapitullit 27 “Mjedisi dhe Ndryshimet Klimatike”.

Për pasojë, mbrojtja e biodiversitetit mbetet e pjesshme dhe jo gjithmonë e harmonizuar me kërkesat evropiane për ruajtjen afatgjatë të habitateve dhe llojeve me rëndësi kombëtare dhe ndërkombëtare.

3. Problemet në menaxhimin e llojeve jo vendase dhe invazive

Llojet jo vendase dhe invazive përbëjnë një nga kërcënimet më serioze për biodiversitetin, pasi mund të konkurrojnë me llojet vendase, të ndryshojnë strukturën e ekosistemeve, të dëmtojnë habitatet natyrore dhe të shkaktojnë humbje të diversitetit biologjik. Kuadri aktual nuk ofron ende një sistem të plotë dhe të standardizuar për parandalimin, zbulimin e hershëm, monitorimin, kontrollin dhe menaxhimin e këtyre llojeve.

Në praktikë, mungesa e procedurave të qarta mund të sjellë reagim të vonuar institucional ndaj rasteve të futjes ose përhapjes së llojeve invazive. Gjithashtu, mungesa e mekanizmave të koordinuar ndërmjet institucioneve përgjegjëse e bën më të vështirë identifikimin e hershëm të rrezikut, përcaktimin e masave të kontrollit dhe ndjekjen e efektivitetit të tyre.

Për pasojë, rreziku i përhapjes së llojeve invazive mbetet i lartë, ndërsa dëmet ndaj habitateve, llojeve vendase dhe shërbimeve të ekosistemeve mund të bëhen më të vështira dhe më të kushtueshme për t’u adresuar në të ardhmen.

³ Sixth National Report of Albania to the Convention on Biological Diversity

⁴ European Commission, Albania Report 2024

4. Mungesa e një kuadri funksional për aksesin në burimet gjenetike dhe ndarjen e përfitimeve

Kuadri aktual nuk garanton ende një sistem të plotë, të qartë dhe funksional për aksesin në burimet gjenetike dhe ndarjen e drejtë e të barabartë të përfitimeve që rrjedhin nga përdorimi i tyre. Kjo fushë lidhet me detyrimet që burojnë nga Protokollu i Nagojës dhe legjislati i përkatës i Bashkimit Evropian, të cilat kërkojnë procedura të qarta autorizimi, kontroll të përdorimit të burimeve gjenetike dhe mekanizma për ndarjen e përfitimeve.

Në mungesë të një kuadri të tillë, institucionet përgjegjëse mund të kenë vështirësi në administrimin dhe kontrollin e përdorimit të burimeve gjenetike. Njëkohësisht, subjektet kërkimore, akademike dhe ekonomike që përdorin këto burime mund të përballen me paqartësi juridike lidhur me procedurat që duhet të ndjekin, të drejtat dhe detyrimet e tyre, si dhe mënyrën e ndarjes së përfitimeve.

Për pasojë, krijohet rrezik për përdorim jo të rregulluar ose jo transparent të burimeve gjenetike, humbje të mundësive për përfitime të drejta për shtetin dhe komunitetet, si dhe vështirësi në përmbushjen e detyrimeve ndërkombëtare në këtë fushë.

5. Problemet në koordinimin institucional dhe ndarjen e përgjegjësisë

Mbrojtja e biodiversitetit kërkon bashkëpunim ndërmjet disa institucioneve qendrore, agjencive zbatuese, njësisë të vetëqeverisjes vendore, institucioneve kërkimore dhe strukturave të kontrollit. Kuadri aktual nuk siguron gjithmonë qartësi të mjaftueshme në ndarjen e roleve dhe përgjegjësisë ndërmjet këtyre institucioneve.

Në praktikë, kjo mund të sjellë mbivendosje kompetencash, boshllëqe në zbatim, shkëmbim të kufizuar informacioni dhe mungesë të një reagimi të koordinuar ndaj problematikave që prekin biodiversitetin. Pa mekanizma të qartë bashkëpunimi dhe raportimi, zbatimi i masave për mbrojtjen e habitateve, llojeve dhe ekosistemeve bëhet më pak efektiv.

Për pasojë, dobësohet aftësia institucionale për të parandaluar dëmtimet ndaj biodiversitetit, për të monitoruar gjendjen e tij dhe për të siguruar zbatim të qëndrueshëm të detyrimeve ligjore në nivel kombëtar dhe vendor.

6. Mekanizma të kufizuar për mbledhjen, administrimin dhe shkëmbimin e të dhënave biologjike

Një problematikë tjetër lidhet me mungesën e mekanizmave të unifikuar për mbledhjen, administrimin dhe shkëmbimin e të dhënave biologjike në nivel kombëtar. Të dhënat mbi biodiversitetin janë shpesh të shpërndara ndërmjet institucioneve, projekteve, studimeve akademike dhe burimeve të tjera, pa një sistem të përbashkët që të garantojë përditësimin, verifikimin dhe aksesueshmërinë e tyre.

Kjo situatë kufizon përdorimin efektiv të informacionit për planifikim, vendimmarrje, monitorim dhe raportim. Mungesa e një baze të konsoliduar të dhënash ndikon edhe në transparencën publike dhe në mundësinë e përfshirjes së institucioneve kërkimore, organizatave të shoqërisë civile dhe grupeve të tjera të interesit në proceset e mbrojtjes së biodiversitetit.

Për pasojë, politikat dhe masat e ndërmarra në këtë fushë rrezikojnë të mos mbështeten gjithmonë në informacion të plotë, të krahasueshëm dhe të përditësuar.

Shkaqet e problemit

Shkaqet kryesore janë:

- Evoluimi i acquis të BE-së dhe standardeve ndërkombëtare, të cilat kanë rritur kërkesat për raportim, monitorim dhe mbrojtje të biodiversitetit.

- Zhvillimet e reja në politikat dhe praktikat ndërkombëtare të ruajtjes së biodiversitetit, të cilat kërkojnë një qasje më të integruar për mbrojtjen e ekosistemeve, habitateve dhe lidhshmërisë ekologjike ndërmjet zonave natyrore.
- Mungesa e një kuadri të plotë ligjor për rregullimin e aksesit në burimet gjenetike dhe ndarjen e drejtë të përfitimeve që rrjedhin nga përdorimi i tyre, në përputhje me kërkesat e Protokollit të Nagojës dhe legjislacionit të Bashkimit Evropian.
- Ekzistenca e dispozitave të fragmentuara dhe jo plotësisht të harmonizuara për monitorimin dhe raportimin e biodiversitetit, si dhe për parandalimin, kontrollin dhe menaxhimin e llojeve jo vendase dhe invazive, duke kufizuar zbatimin e një qasjeje të unifikuar dhe në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian. Koordinim institucional i pamjaftueshëm, i karakterizuar nga mbivendosje kompetencash dhe mungesë e qartësisë në ndarjen e përgjegjësiave ndërmjet institucioneve përgjegjëse për monitorimin, menaxhimin dhe zbatimin e politikave të biodiversitetit.

Mekanizma të kufizuar dhe jo të unifikuar për mbledhjen, administrimin dhe shkëmbimin e të dhënave biologjike në nivel kombëtar, duke ndikuar në cilësinë dhe aksesueshmërinë e informacionit mbi biodiversitetin.

Pasojat që rrjedhin nga problematikat e identifikuara:

Problematikat e mësipërme sjellin pasoja të drejtpërdrejta dhe të tërthorta në mbrojtjen dhe menaxhimin e biodiversitetit, në funksionimin e institucioneve përgjegjëse, në sigurinë juridike të subjekteve të prekura dhe në përmbushjen e detyrimeve kombëtare e ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë.

Së pari, mungesa e një sistemi të integruar dhe të standardizuar monitorimi kufizon aftësinë e institucioneve për të pasur të dhëna të sakta, të krahasueshme dhe të përditësuara mbi gjendjen e habitateve, llojeve dhe ekosistemeve. Si pasojë, vendimmarrja mbi masat e ruajtjes së biodiversitetit mund të mos mbështetet gjithmonë në evidenca të plota shkencore, ndërsa raportimet kombëtare dhe ndërkombëtare mund të jenë të fragmentuara ose të paplota.

Së dyti, përafrimi jo i plotë me kërkesat e Bashkimit Evropian krijon vështirësi në zbatimin e standardeve të acquis për mbrojtjen e natyrës. Kjo mund të ndikojë negativisht në procesin e integritetit evropian, veçanërisht në kuadër të Kapitullit 27 “Mjedisi dhe Ndryshimet Klimatike”, si dhe të vonojë përmbushjen e detyrimeve që lidhen me mbrojtjen e habitateve natyrore, llojeve të egra dhe shpendëve.

Së treti, mungesa e mekanizmave të plotë për menaxhimin e llojeve jo vendase dhe invazive rrit rrezikun e futjes, përhapjes dhe vendosjes së tyre në ekosistemet natyrore. Kjo mund të sjellë konkurrencë me llojet vendase, degradim të habitateve, ndryshim të ekuilibrave ekologjikë dhe humbje të diversitetit biologjik, me pasoja afatgjata për ekosistemet dhe shërbimet që ato ofrojnë.

Së katërti, mungesa e një kuadri funksional për aksesin në burimet gjenetike dhe ndarjen e përfitimeve krijon paqartësi për institucionet publike, subjektet kërkimore, akademike dhe operatorët ekonomikë që përdorin burime gjenetike. Kjo mund të sjellë pasiguri juridike, vështirësi në kontrollin e përdorimit të burimeve gjenetike, mungesë transparence dhe mosgarantim të ndarjes së drejtë e të barabartë të përfitimeve.

Së pesti, paqartësia në ndarjen e përgjegjësiave institucionale dhe koordinimi i pamjaftueshëm mund të sjellin mbivendosje kompetencash, boshllëqe në zbatim dhe reagim të vonuar ndaj

problematikave që prekin biodiversitetin. Kjo ul efektivitetin e politikave publike dhe dobëson zbatimin e masave mbrojtëse në nivel kombëtar dhe vendor.

Së gjashti, pasojat prekin edhe komunitetet lokale, bizneset dhe publikun e gjerë. Degradimi i habitateve dhe humbja e biodiversitetit mund të ndikojnë në cilësinë e mjedisit, në përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, në zhvillimin e turizmit natyror, në bujqësi, pylltari dhe në sektorë të tjerë që varen nga shërbimet e ekosistemeve. Në afat të gjatë, këto pasoja mund të ndikojnë negativisht në mirëqenien e komuniteteve dhe në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik e social.

Për këto arsye, problematikat e identifikuar nuk kanë vetëm natyrë rregullator ose institucionale, por prodhojnë pasoja praktike në ruajtjen e biodiversitetit, në menaxhimin e burimeve natyrore, në funksionimin e administratës publike dhe në përmbushjen e detyrimeve të Shqipërisë ndaj Bashkimit Evropian dhe instrumenteve ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes së natyrës.

Shtrirja e problemit

Problemi ka shtrirje kombëtare dhe prek të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, duke përfshirë:

- zonat e mbrojtura;
- habitatet natyrore dhe ekosistemet tokësore dhe ujore;
- llojet e egra të florës dhe faunës;
- territorin ku zhvillohen aktivitete me ndikim në biodiversitet (bujqësi, pylltari, turizëm, ndërtim, kërkim shkencor).

Në aspektin institucional, problemi shtrihet në disa nivele qeverisjeje dhe administrimi, përfshirë institucionet qendrore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Grupet e prekura nga problemi

Problematikat e identifikuar në kuadrin aktual për mbrojtjen e biodiversitetit prekin disa grupe interesi, si në nivel institucional, ashtu edhe në nivel ekonomik, shoqëror dhe mjedisor. Ndikimi mbi secilin grup lidhet me rolin që ai ka në administrimin, përdorimin, monitorimin ose përfitimin nga burimet natyrore dhe shërbimet e ekosistemeve.

1. Qeveria dhe institucionet publike qendrore

Institucionet publike qendrore, përfshirë ministrinë përgjegjëse për mjedisin, Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura dhe institucionet e tjera përgjegjëse, preken drejtpërdrejt nga problematikat e kuadrit aktual. Mungesa e një sistemi të integruar dhe të standardizuar monitorimi e vështirëson mbledhjen, administrimin dhe përdorimin e të dhënave për biodiversitetin.

Këto institucione përballen me vështirësi në përgatitjen e raportimeve të plota, të krahasueshme dhe periodike, veçanërisht në raport me detyrimet që rrjedhin nga *acquis* i Bashkimit Evropian. Gjithashtu, paqartësia në ndarjen e përgjegjësisë mund të sjellë mbivendosje kompetencash, boshllëqe në zbatim dhe ulje të efektivitetit të masave për ruajtjen e habitateve dhe llojeve.

2. Njësitë e vetëqeverisjes vendore

Njësitë e vetëqeverisjes vendore preken sepse shumë nga problematikat e biodiversitetit shfaqen në territorin që ato administrojnë. Ato kanë rol në planifikimin vendor, administrimin e territorit, menaxhimin e burimeve natyrore dhe bashkëpunimin me strukturat qendrore për mbrojtjen e mjedisit.

Në mungesë të udhëzimeve të qarta, të dhënave të përditësuara dhe mekanizmave të mirëkoordinuar, njësitë vendore mund të kenë vështirësi në identifikimin e zonave me ndjeshmëri të lartë mjedisore, në parandalimin e dëmtimeve ndaj habitateve dhe në ndërmarrjen e masave të duhura për menaxhimin e llojeve invazive. Kjo mund të ndikojë edhe në cilësinë e planifikimit territorial dhe në zbatimin e politikave vendore për zhvillim të qëndrueshëm.

3. Administruesit e zonave të mbrojtura

Administruesit e zonave të mbrojtura preken drejtpërdrejt, pasi zonat e mbrojtura përmbajnë një pjesë të rëndësishme të habitateve dhe llojeve me vlerë të lartë natyrore. Mungesa e të dhënave të standardizuara dhe e mekanizmave të qartë të monitorimit mund të vështirësojë vlerësimin e gjendjes së habitateve dhe llojeve brenda këtyre zonave.

Kjo ndikon në hartimin dhe zbatimin e planeve të menaxhimit, në përcaktimin e masave të ruajtjes dhe në reagimin ndaj presioneve si degradimi i habitateve, aktivitetet e paligjshme, turizmi i pakontrolluar ose përhapja e llojeve invazive. Për pasojë, efektiviteti i administrimit të zonave të mbrojtura mund të mbetet i kufizuar.

4. Bizneset dhe operatorët ekonomikë

Bizneset dhe operatorët ekonomikë preken kryesisht në rastet kur veprimtaria e tyre lidhet me përdorimin e burimeve biologjike ose gjenetike, me turizmin natyror, bujqësinë, pyjet, peshkimin, kërkimin shkencor, bioteknologjinë ose veprimtari të tjera që mund të ndikojnë mbi biodiversitetin. Mungesa e rregullave të qarta për aksesin në burimet gjenetike dhe ndarjen e përfitimeve mund të krijojë pasiguri juridike për subjektet që përdorin këto burime. Gjithashtu, mungesa e standardeve të qarta për mbrojtjen e habitateve dhe llojeve mund të vështirësojë planifikimin afatgjatë të investimeve dhe përshtatjen e veprimtarive ekonomike me kërkesat mjedisore. Në të njëjtën kohë, degradimi i biodiversitetit mund të ndikojë negativisht mbi sektorë që varen nga cilësia e mjedisit, si turizmi natyror, bujqësia dhe pylltaria.

5. Institucionet akademike dhe kërkimore

Institucionet akademike dhe kërkimore preken për shkak të rolit të tyre në studimin, monitorimin dhe vlerësimin e biodiversitetit. Mungesa e një sistemi të unifikuar të të dhënave biologjike kufizon aksesin në informacion të plotë, të përditësuar dhe të krahasueshëm.

Kjo mund të ndikojë në cilësinë e kërkimit shkencor, në mundësinë për të kontribuar në monitorimin kombëtar të biodiversitetit dhe në përdorimin e rezultateve shkencore për politikëbërje. Gjithashtu, paqartësitë mbi aksesin në burimet gjenetike mund të krijojnë vështirësi për projektet kërkimore që lidhen me përdorimin e materialeve biologjike ose gjenetike.

6. Organizatat e shoqërisë civile

Organizatat e shoqërisë civile preken sepse ato kanë rol të rëndësishëm në mbrojtjen e mjedisit, ndërgjegjësimin publik, monitorimin e pavarur dhe pjesëmarrjen në proceset e konsultimit. Mungesa e të dhënave të aksesueshme dhe e mekanizmave të qartë të raportimit mund të kufizojë aftësinë e tyre për të ndjekur gjendjen e biodiversitetit dhe për të kontribuar me rekomandime të bazuara në evidenca.

Gjithashtu, nëse koordinimi institucional dhe transparenca janë të kufizuara, pjesëmarrja e shoqërisë civile në proceset vendimmarrëse bëhet më pak efektive. Kjo mund të ndikojë në cilësinë e konsultimit publik dhe në nivelin e llogaridhënies për politikën e mbrojtjes së biodiversitetit.

7. Komunitetet lokale

Komunitetet lokale, veçanërisht ato që jetojnë pranë zonave të mbrojtura, pyjeve, lagunave, lumenjve, zonave bregdetare apo ekosistemeve të tjera natyrore, preken drejtpërdrejt nga gjendja e biodiversitetit. Këto komunitete shpesh përfitojnë nga burimet natyrore për jetesë, punësim, turizëm, bujqësi, peshkim ose aktivitete tradicionale.

Degradimi i habitateve, humbja e llojeve ose përhapja e llojeve invazive mund të ndikojë në cilësinë e burimeve natyrore, në të ardhurat lokale dhe në mundësitë për zhvillim të qëndrueshëm. Në mungesë të një menaxhimi efektiv të biodiversitetit, komunitetet lokale mund të përballen me ulje të përfitimeve nga shërbimet e ekosistemeve dhe me kufizim të mundësive ekonomike që lidhen me natyrën.

8. Qytetarët dhe publiku i gjerë

Qytetarët preken si përfitues të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë të shërbimeve të ekosistemeve. Biodiversiteti ndikon në cilësinë e ajrit, ujit, peizazhit, rekreacionit, shëndetit publik dhe mirëqenies së përgjithshme.

Nëse biodiversiteti nuk monitorohet dhe mbrohet në mënyrë efektive, qytetarët mund të përballen me përkeqësim të cilësisë së mjedisit, humbje të hapësirave natyrore, reduktim të mundësive për rekreacion dhe ulje të përfitimeve që vijnë nga ekosistemet e shëndetshme. Për këtë arsye, ndikimi i problemit nuk kufizohet vetëm te institucionet apo bizneset, por shtrihet edhe te publiku i gjerë.

Problemi mund të trajtohet në mënyrë efektive përmes ndryshimit të politikave ekzistuese

Arsyeja e ndërhyrjes

- *Shpjegoni pse qeveria planifikon të ndërhyjë dhe pse është e nevojshme.*
- *Shpjegoni se çfarë shpreson të trajtojë qeveria nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje.*
- *Identifikoni shkallën e ndërhyrjes së qeverisë që nevojitet për të trajtuar problemin.*
- *Shpjegoni se si i mbështet kjo ndërhyrje objektivat e nivelit të lartë të qeverisë.*
- *Rendisni punën ekzistuese që është realizuar tashmë.*

Mbrojtja e biodiversitetit përbën një objektiv të rëndësishëm të politikave publike të Republikës së Shqipërisë, në funksion të ruajtjes së kapitalit natyror, përdorimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe përmbushjes së detyrimeve që rrjedhin nga procesi i integritetit evropian dhe marrëveshjet ndërkombëtare në fushën e mjedisit.

Arsyeja e ndërhyrjes lidhet me faktin se kuadri aktual për mbrojtjen e biodiversitetit nuk arrin të adresojë në mënyrë të plotë disa problematika të evidentuara gjatë zbatimit të tij. Këto problematika lidhen me mungesa dhe paqartësi në monitorimin, raportimin, administrimin dhe mbrojtjen e biodiversitetit, si dhe me kufizime në përmbushjen e kërkesave që rrjedhin nga standardet evropiane dhe ndërkombëtare në këtë fushë.

Në mënyrë të veçantë, janë evidentuar nevoja për forcimin e:

- sistemeve të monitorimit dhe raportimit të biodiversitetit në përputhje me standardet evropiane;
- kuadrit për mbrojtjen dhe menaxhimin e habitateve dhe lidhshmërisë ekologjike;
- rregullave për menaxhimin e llojeve jo vendase dhe invazive;
- mekanizmave për aksesin në burimet gjenetike dhe ndarjen e përfitimeve (ABS), në përputhje me Protokollin e Nagojës dhe Rregulloren (BE) nr. 511/2014;
- qartësimin të përgjegjësiave institucionale dhe koordinimit ndërinstitucional.

Në këtë kontekst, politika aktuale synon përmirësimin dhe modernizimin e kuadrit ligjor ekzistues, duke siguruar një përafrim më të plotë me acquis të BE-së, forcimin e zbatimit praktik dhe rritjen e efektivitetit të instrumenteve të mbrojtjes së biodiversitetit, pa krijuar struktura të reja institucionale dhe duke u bazuar në kapacitetet ekzistuese shtetërore.

Në praktikë, sistemi ekzistues i monitorimit dhe raportimit të biodiversitetit nuk është plotësisht i integruar dhe i standardizuar. Të dhënat për habitatet natyrore, llojet e egra dhe ekosistemet mbledhen dhe administrohen në mënyrë të fragmentuar, duke kufizuar krahasueshmërinë, besueshmërinë dhe përdorimin e tyre për vendimmarrje. Kjo ndikon në cilësinë e vlerësimit të gjendjes së biodiversitetit dhe në aftësinë e institucioneve për të përgatitur raportime të plota dhe të rregullta.

Një tjetër arsye lidhet me mungesën e përafrimit të plotë të kuadrit aktual me kërkesat e acquis të Bashkimit Evropian në fushën e mbrojtjes së natyrës. Kjo mungesë krijon vështirësi në zbatimin e standardeve që lidhen me ruajtjen e habitateve natyrore, mbrojtjen e llojeve të egra, mbrojtjen strikte të disa llojeve dhe raportimin mbi statusin e tyre të ruajtjes.

Gjithashtu, kuadri aktual nuk trajton në mënyrë të plotë dhe të strukturuar rreziqet që lidhen me llojet jo vendase dhe invazive. Mungesa e mekanizmave të qartë për parandalimin, zbulimin e hershëm, monitorimin dhe kontrollin e tyre mund të sjellë reagim të vonuar institucional dhe rritje të presionit mbi llojet vendase, habitatet natyrore dhe ekosistemet.

Në fushën e aksesit në burimet gjenetike dhe ndarjes së përfitimeve, kuadri ekzistues nuk ofron qartësi të mjaftueshme për procedurat, përgjegjësitë institucionale dhe mënyrën e administrimit të këtyre burimeve. Kjo krijon paqartësi për institucionet publike, subjektet kërkimore, akademike dhe operatorët ekonomikë, si dhe kufizon transparencën dhe sigurinë juridike në përdorimin e burimeve gjenetike.

Një tjetër arsye, që justifikon ndërhyrjen e qeverisë lidhet me paqartësinë në ndarjen e përgjegjësiave ndërmjet institucioneve që kanë rol në mbrojtjen, monitorimin dhe administrimin e biodiversitetit. Në mungesë të një koordinimi të qartë, mund të krijohen mbivendosje kompetencash, boshllëqe në zbatim, shkëmbim i kufizuar informacioni dhe ulje e efektivitetit të masave mbrojtëse.

Këto mangësi tregojnë se problemi nuk është vetëm formal apo ligjor, por lidhet me funksionimin praktik të sistemit të mbrojtjes së biodiversitetit. Për këtë arsye, vlerësimi i ndërhyrjes publike është i nevojshëm për të analizuar shkallën e problemit, grupet e prekura,

pasoja që sjell mosfunksionimi aktual dhe mënyrat e mundshme të adresimit të tij në përputhje me objektivat e politikave publike dhe detyrimet ndërkombëtare të vendit.

Nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje, qeveria synon të adresojë boshllëqet ekzistuese në kuadrin ligjor dhe institucional për aksesin në burimet gjenetike dhe ndarjen e drejtë e të barabartë të përfitimeve që rrjedhin nga përdorimi i tyre, në përputhje me kërkesat e Protokollit të Nagojës dhe Rregullores (BE) nr. 511/2014 për ABS. Ndërhyrja synon të krijojë një bazë të qartë ligjore për procedurat e aksesit në burimet gjenetike, përcaktimin e përgjegjësiwe institucionale, monitorimin e përdorimit të këtyre burimeve dhe sigurimin e përputhshmërisë së përdoruesve me detyrimet për kujdesin e duhur.

Qeveria synon gjithashtu të garantojë që përdorimi i burimeve gjenetike dhe njohurive tradicionale të lidhura me to të realizohet në mënyrë të ligjshme, transparente dhe të qëndrueshme, duke mbrojtur interesin publik, biodiversitetin dhe të drejtat e palëve që ofrojnë këto burime. Përmes këtij rregullimi, pritjet të rritet siguria juridike për institucionet kërkimore, operatorët ekonomikë dhe përdoruesit e tjerë, të forcohet kontrolli ndaj përdorimit të burimeve gjenetike dhe të sigurohet ndarja e drejtë e përfitimeve, në funksion të ruajtjes së biodiversitetit dhe zhvillimit të qëndrueshëm.

Kjo ndërhyrje mbështet njëkohësisht procesin e përafrimit të legjislacionit kombëtar me acquis të Bashkimit Evropian në fushën e mjedisit, veçanërisht në kuadër të Kapitullit 27, dhe kontribuon në përmbushjen e detyrimeve ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë në fushën e mbrojtjes së biodiversitetit.

Ndërhyrja mbështet drejtpërdrejt objektivat strategjike të qeverisë, veçanërisht lidhet me:

- **Strategjine Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022–2030 (SKZHIE)** miratuar me VKM nr. 88, datë 22.02.2023 si dokumenti strategjik kryesor kombëtar, pasi mbështet prioritetet e saj për zhvillim të qëndrueshëm, mbrojtje të mjedisit, ruajtje të biodiversitetit dhe përparim në procesin e integritimit evropian. Ndërhyrja synon përafrimin me acquis të BE-së në fushën e mjedisit, veçanërisht me Rregulloren (BE) nr. 511/2014 për aksesin në burimet gjenetike dhe ndarjen e përfitimeve. Në këtë mënyrë, kontribuon në përmbushjen e objektivave të Kapitullit 27 “Mjedisi dhe ndryshimet klimatike”, forcimin e kuadrit institucional për mbrojtjen e biodiversitetit dhe menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore.
- **Dokumenti i Politikave Strategjike për Mbrojtjen e Biodiversitetit**, miratuar me VKM nr. 31, datë 20.01.2016, i cili përcakton drejtimit strategjike dhe objektivat kombëtare për ruajtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të biodiversitetit, përmirësimin e kuadrit ligjor dhe institucional, forcimin e monitorimit dhe raportimit, si dhe rritjen e efektivitetit të masave për mbrojtjen e habitateve dhe llojeve. Ndërhyrja e propozuar kontribuon në zbatimin e këtyre objektivave..
- **Mbrojtjen e mjedisit dhe biodiversitetit**, duke forcuar ruajtjen e habitateve dhe llojeve të egra;
- **Zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik**, përmes përdorimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe mbështetjes së sektorëve të gjelbër;
- **Forcimin e qeverisjes dhe transparencës institucionale**, përmes qartësimit të përgjegjësiwe dhe përmirësimit të raportimit;
- **Përmbushjen e detyrimeve ndërkombëtare**, përfshirë Konventën për Diversitetin Biologjik dhe Protokollin e Nagojës.

Deri më tani janë ndërmarrë disa hapa të rëndësishëm në këtë fushë:

Është miratuar Ligji nr. 9587/2006 “Për mbrojtjen e biodiversitetit”, i ndryshuar dhe janë hartuar dhe miratuar aktet nënligjore në zbatim të tij.

Është bërë transpozimi i pjesshëm i kërkesave të Direktivës 92/43/KEE dhe Direktivës 2009/147/KE në legjislacionin kombëtar, si dhe është siguruar përfshirja e dispozitave për mbrojtjen e natyrës në legjislacionin për gjuetinë dhe në legjislacionin penal për veprat mjedisore.

Kuadri ekzistues zbatohet në praktikë nga strukturat përgjegjëse për administrimin e zonave të mbrojtura, agjencitë mjedisore dhe strukturat inspektuese, të cilat në punën e tyre të përditshme kryejnë monitorimin e gjendjes së biodiversitetit, ndjekin zbatimin e planeve të menaxhimit, japin mendime teknike për veprimtari me ndikim në mjedis, verifikojnë respektimin e kushteve ligjore në terren dhe raportojnë mbi problematikat e konstatuara. Përfshirja e këtyre strukturave në zbatimin e legjislacionit ka mundësuar kontroll më të vazhdueshëm të veprimtarive që ndikojnë në habitatet, llojet e mbrojtura dhe zonat e mbrojtura. Megjithatë, puna e përditshme ka evidentuar nevojën për koordinim më të mirë institucional, shkëmbim më efektiv të të dhënave, standardizim të monitorimit dhe qartësim të përgjegjësisë ndërmjet institucioneve, çka adresohet përmes ndërhyrjes së propozuar..

Në zbatim të kuadrit ekzistues ligjor për mbrojtjen e biodiversitetit janë zhvilluar disa instrumente fillestare të planifikimit, menaxhimit, monitorimit dhe raportimit, të cilat kanë krijuar një bazë të rëndësishme për administrimin më të mirë të vlerave natyrore. Në këtë kuadër, për disa zona të mbrojtura janë hartuar dhe zbatuar plane menaxhimi, të cilat përcaktojnë objektivat e ruajtjes, zonimin e brendshëm, masat e lejuara dhe të ndaluara, ndërhyrjet prioritare, si dhe përgjegjësitë e strukturave administruese. Këto plane shërbejnë si instrumente praktike për orientimin e punës së përditshme të administratave të zonave të mbrojtura, për menaxhimin e vizitorëve, kontrollin e veprimtarive me ndikim në natyrë, bashkëpunimin me komunitetet lokale dhe raportimin mbi gjendjen e habitateve dhe llojeve.

Gjithashtu, institucionet përgjegjëse kanë ndërmarrë hapa për identifikimin dhe klasifikimin e habitateve natyrore dhe llojeve të florës e faunës me rëndësi kombëtare dhe ndërkombëtare. Ky proces ka ndihmuar në përcaktimin e prioriteteve të ruajtjes, në evidentimin e zonave me vlera të veçanta ekologjike, si dhe në orientimin e vendimmarrjes për planifikimin territorial, vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe administrimin e zonave të mbrojtura. Megjithatë, ky informacion nuk është ende plotësisht i standardizuar, i përditësuar në mënyrë periodike dhe i integruar në një sistem të unifikuar kombëtar të të dhënave për biodiversitetin.

Një instrument i rëndësishëm parandalues ka qenë edhe përdorimi i procedurave të vlerësimit të ndikimit në mjedis, përmes të cilave vlerësohen paraprakisht ndikimet e projekteve apo veprimtarive të caktuara mbi habitatet natyrore, llojet e mbrojtura, zonat e mbrojtura dhe elementë të tjerë të biodiversitetit. Në praktikë, VNM-ja ka shërbyer për vendosjen e kushteve mjedisore, shmangien ose reduktimin e ndikimeve negative dhe orientimin e subjekteve drejt masave zbutëse. Në vijim të zbatimit të Dokumentit të Politikave Strategjike për Mbrojtjen e Biodiversitetit, miratuar me VKM nr. 31, datë 20.01.2016, janë ndërmarrë masa për zhvillimin e kuadrit ligjor dhe institucional, përmirësimin e administrimit të zonave të mbrojtura, forcimin e monitorimit dhe përmirësimin gradual të mekanizmave të raportimit të biodiversitetit. Megjithatë, përvoja e zbatimit ka treguar nevojën për forcimin e lidhjes ndërmjet VNM-së, të dhënave të monitorimit të biodiversitetit dhe vendimmarrjes institucionale, në mënyrë që ndikimet mbi biodiversitetin të vlerësohen mbi bazën e informacionit sa më të plotë dhe të përditësuar.

Në lidhje me sistemet e të dhënave dhe monitorimin, janë krijuar baza fillestare informacioni për biodiversitetin dhe janë zhvilluar praktika raportimi nga institucionet përgjegjëse, përfshirë

strukturat që administrojnë zonat e mbrojtura, agjencitë mjedisore dhe institucionet e tjera të përfshira në monitorim. Këto të dhëna përdoren për vlerësimin e gjendjes së habitateve dhe llojeve, evidentimin e presioneve kryesore, raportimin institucional dhe mbështetjen e proceseve të planifikimit e menaxhimit. Megjithatë, sistemet aktuale mbeten të fragmentuara, jo gjithmonë të ndërveprueshme dhe me metodologji raportimi ende jo plotësisht të standardizuara.

Për këtë arsye, ndërhyrja e propozuar synon të konsolidojë dhe forcojë mekanizmat ekzistues të planifikimit, menaxhimit, monitorimit dhe raportimit të biodiversitetit, duke krijuar një bazë më të qartë ligjore për mbledhjen, administrimin, shkëmbimin dhe përdorimin e të dhënave. Kjo do të mundësojë vendimmarrje më të informuar, raportim më të besueshëm, përputhje më të mirë me kërkesat e acquis të Bashkimit Evropian dhe zbatim më efektiv të masave për ruajtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të biodiversitetit. Në mënyrë të veçantë, forcimi i sistemeve të të dhënave dhe raportimit është i rëndësishëm edhe për zbatimin e rregullave për aksesin në burimet gjenetike dhe ndarjen e përfitimeve, pasi administrimi efektiv i këtyre burimeve kërkon informacion të saktë, gjurmueshmëri, koordinim institucional dhe mekanizma kontrolli të përputhshmërisë.

Megjithatë, këto hapa kanë nevojë për konsolidim dhe zgjerim për të arritur nivelin e kërkuar të përputhshmërisë dhe efektivitetit në zbatim.

Objekti i politikës

- *Vendosni objektiva që korrespondojnë me problemin dhe shkaqet e tij.*
- *Sigurohuni që objektivat janë specifike, të matshme, të arritshme, reale dhe në kohë*

Objekti i përgjithshëm është që, deri në vitin 2030, kuadri ligjor dhe institucional për biodiversitetin të jetë funksional, i monitorueshëm dhe i përafruar me detyrimet përkatëse të Bashkimit Evropian.

Nr.	Objekti i matshëm	Vlera bazë – 2026	Targeti i synuar	Afati	Burimi i verifikimit
1	Kuadri ligjor me acquis të BE-së për biodiversitetin i përafruar	0% e dispozitave të reja të projektligjit janë në fuqi para miratimit.	100% e dispozitave dhe akteve zbatuese të planifikuara në tabelën e përputhshmërisë të miratuara.	2027	Tabela e përputhshmërisë; ligji dhe aktet nënligjore.
2	Monitorimi dhe raportimi kombëtar i standardizuar.	0 metodologji e unifikuar sipas kuadrit të ri; të dhënat janë të fragmentuara.	Të paktën 1 metodologji; 1 përditësim i bazës së të dhënave dhe 1 raport kombëtar çdo vit.	2027	Aktet miratuese; sistemi i informacionit; raportet AKM/AKZM.
3	Habitat natyrore prioritare të monitoruara.	0 program kombëtar i integruar sipas kuadrit të ri.	100% e habitateve prioritare në programin vjetor dhe 1 raport statusi çdo vit.	2027	Programet dhe raportet e monitorimit.
4	Llojet prioritare të monitoruara dhe mbrojtura.	0 program kombëtar i standardizuar sipas kuadrit të ri.	100% e llojeve prioritare në programin vjetor dhe 1 raport vjetor.	2027	Listat prioritare; programet dhe raportet vjetore.
5	Sistemit ABS funksional	0 regjistër operacional dhe 0 procedurë standarde sipas kuadrit të ri.	1 regjistër dhe 1 procedurë funksionale; 100% e kërkesave dhe autorizimeve të regjistruhen.	2027	Regjistri ABS; autorizimet; raportet.
6	Ndarja e drejtë dhe e barabartë e përfitimeve.	0 model standard i miratuar.	1 model standard; 100% e autorizimeve përkatëse me kushte të dokumentuara.	2027	Modelet, marrëveshjet dhe autorizimet ABS.
7					
8					

Kjo politikë synon arritjen e objektivave SMART në fushën e mbrojtjes dhe menaxhimit të biodiversitetit, përmes përmirësimit të kuadrit ligjor dhe institucional, forcimit të mekanizmave të monitorimit dhe raportimit, përafrimit me acquis të Bashkimit Evropian dhe garantimit të përdorimit të qëndrueshëm të burimeve biologjike.

Objektivat e mësipërm synojnë adresimin e drejtpërdrejtë të problematikave të identifikuara në analizën e problemit, konkretisht mangësive në përafrimin e kuadrit ligjor me acquis të Bashkimit Evropian, mungesës së një sistemi plotësisht të standardizuar të monitorimit dhe raportimit të biodiversitetit, nevojës për forcimin e mbrojtjes së habitateve dhe llojeve të egra, mungesës së një kuadri funksional për aksesin në burimet gjenetike dhe ndarjen e përfitimeve, si dhe paqartësive në koordinimin institucional.

Arritja e këtyre objektivave pritet të përmirësojë efektivitetin e zbatimit të legjislacionit për biodiversitetin, të rrisë cilësinë e të dhënave dhe raportimeve, të forcojë mbrojtjen e vlerave natyrore dhe të kontribuojë në përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga procesi i integritetit evropian dhe marrëveshjet ndërkombëtare në fushën e biodiversitetit.

Përshkrimi i opsioneve të shqyrtuara

- *Përshkruani opsionin e status quo-së.*
- *Identifikoni dhe përshkruani të gjitha opsionet e politikave që keni marrë parasysh.*
- *Shpjegoni se si janë zgjedhur opsionet e renditura.*

Opsioni 0- Mosndërhyrja (Status quo)së nënkupton ruajtjen e kuadrit ligjor ekzistues pa asnjë ndryshim në Ligjin nr. 9587/2006 “Për mbrojtjen e biodiversitetit”.

Në këtë skenar:

- vazhdon zbatimi i dispozitave aktuale pa përmirësime strukturore ose përmbajtësore;
- nuk adresohen boshllëqet e identifikuara në përafrimin me acquis të BE-së;
- mbeten të pandryshuara mekanizmat ekzistues për monitorim, raportim dhe kontroll;
- nuk krijohet bazë e plotë ligjore për sistemin ABS;
- vazhdojnë kufizimet në menaxhimin e llojeve invazive dhe në qartësinë institucionale.

Ky opsion do të ruante stabilitetin institucional, por nuk do të mundësonte përmbushjen e detyrimeve të reja të integritetit evropian dhe do të linte të pazgjidhura mangësitë aktuale të kuadrit ligjor.

Opsioni 1 – Opsion jorregullator

Ky opsion parashikon përmirësimin e zbatimit të kuadrit ekzistues përmes masave administrative dhe teknike, pa ndryshuar ligjin nr. 9587/2006.

Në kuadër të këtij opsioni do të ndërmerren masa si:

- hartimi i udhëzimeve dhe procedurave teknike;
- forcimi i trajnimeve për institucionet përgjegjëse;
- përmirësimi i koordinimit ndërinstitucional;
- standardizimi i praktikave të monitorimit dhe raportimit;
- rritja e ndërgjegjësimit dhe përmirësimi i shkëmbimit të informacionit ndërmjet aktorëve të përfshirë.

Avantazhet:

- mund të zbatohet në një periudhë më të shkurtër kohore;
- kërkon kosto më të ulëta administrative krahasuar me ndërhyrjet ligjore;
- mund të përmirësojë zbatimin praktik të kuadrit ekzistues.

Disavantazhet:

- nuk mund të adresojë problematikat që kërkojnë bazë të re ligjore;
- nuk mundëson përafrimin e plotë me acquis të Bashkimit Evropian;

- nuk krijon kuadrin e nevojshëm ligjor për ABS, përcaktimin e kompetencave të reja dhe menaxhimin e plotë të llojeve invazive.

Ky option vlerësohet si i dobishëm për përmirësimin e zbatimit, por i pamjaftueshëm për adresimin e plotë të problematikave të identifikuara.

Opsioni 2 – Ndryshime të pjesshme përmes ndërhyrjeve të kufizuara

Ky option parashikon përmirësimin e disa aspekteve të zbatimit përmes akteve nënligjore, procedurave dhe udhëzimeve, pa ndryshuar ligjin bazë.

Avantazhet:

- mundëson rregullim më të detajuar të disa procedurave teknike;
- kërkon më pak kohë sesa ndryshimi i ligjit;
- mund të përmirësojë zbatimin praktik të dispozitave ekzistuese.

Disavantazhet:

- nuk mund të tejkalojë kufizimet e ligjit ekzistues;
- nuk mund të krijojë detyrime apo kompetenca të reja që kërkojnë bazë ligjore;
- është i pamjaftueshëm për të adresuar boshllëqet kryesore që lidhen me përafrimin me BE-në, ABS-in dhe menaxhimin e llojeve invazive.

Ky option do të sillte përmirësime të pjesshme, por nuk do të garantonte arritjen e objektivave të politikës.

Opsioni 3 – Amendimi i ligjit ekzistues (opsioni i preferuar)

Ky option parashikon ndërhyrje në ligjin nr. 9587/2006, me qëllim adresimin e boshllëqeve kryesore ligjore dhe institucionale.

Ndërhyrja do të synojë:

- përafrimin e mëtejshëm të kuadrit kombëtar me acquis të Bashkimit Evropian;
- forcimin e sistemit të monitorimit dhe raportimit të biodiversitetit;
- krijimin e bazës ligjore për aksesin në burimet gjenetike dhe ndarjen e përfitimeve;
- përmirësimin e menaxhimit të llojeve jo vendase dhe invazive;
- qartësimin e roleve dhe përgjegjësiwe institucionale.

Avantazhet:

- adreson drejtpërdrejt problematikën që kërkon ndërhyrje ligjore;
- mundëson përafrim më të plotë me acquis të Bashkimit Evropian;
- krijon bazë të qartë ligjore për procedurat dhe përgjegjësitë institucionale;
- përdor strukturat ekzistuese institucionale dhe shmang krijimin e një sistemi tërësisht të ri;
- përmirëson mekanizmat e monitorimit, raportimit dhe menaxhimit të biodiversitetit.

Disavantazhet:

- kërkon procedurë ligjore për hartim, konsultim dhe miratim;
- kërkon përshtatje të praktikave institucionale pas hyrjes në fuqi;
- mund të kërkojë forcim gradual të kapaciteteve teknike dhe administrative.

Ky option konsiderohet alternativa më proporcionale dhe më efektive, pasi adreson problematikën e identifikuara duke përdorur kuadrin ekzistues ligjor dhe institucional.

Opsioni 4 – Hartimi i një ligji të ri për biodiversitetin

Ky opsion parashikon zëvendësimin e ligjit aktual me një kuadër të ri ligjor të plotë për biodiversitetin.

Avantazhet:

- krijon mundësi për riorganizim të plotë të kuadrit ligjor;
- mund të integrojë në mënyrë tërësore të gjitha kërkesat e reja kombëtare dhe evropiane;
- mund të shmangë fragmentimin e dispozitave ekzistuese.

Disavantazhet:

- kërkon kohë më të gjatë për hartim, konsultim dhe miratim;
- mund të sjellë kosto më të larta administrative;
- mund të krijojë pasiguri gjatë periudhës së tranzicionit;
- nuk është proporcional nëse problematikat mund të adresohen përmes ndryshimit të ligjit ekzistues.

Opsionet janë identifikuar dhe përzgjedhur bazuar në:

- **Analizën e boshllëqeve ligjore dhe institucionale** në kuadrin ekzistues;
- **Kërkesat e përafrimit me acquis të BE-së**, veçanërisht Direktiva 92/43/KEE dhe Direktiva 2009/147/KE;
- **Detyrimet ndërkombëtare**, përfshirë Protokollin e Nagojës dhe Rregulloren (BE) nr. 511/2014;
- **Kapacitetet ekzistuese institucionale**, me qëllim shmangien e krijimit të strukturave të reja të panevojshme;
- **Parimin e proporcionalitetit dhe efikasitetit**, duke vlerësuar koston, kohën e zbatimit dhe ndikimin;
- **Nevojën për zbatim të shpejtë dhe efektiv**, në kuadër të procesit të integritetit evropian.

Nga kjo analizë, janë përjashtuar qasjet ekstreme (mosndërhyrja dhe hartimi i një ligji të ri) si joefektive ose jo proporcionale, ndërsa është vlerësuar se një ndërhyrje e plotë në ligjin ekzistues (Opsioni 3) siguron balancën më të mirë midis efektivitetit, koston dhe shpejtësisë së zbatimit.

Vlerësimi i opsioneve/analizimi i ndikimeve

- *Identifikoni se kush preket.*
- *Identifikoni llojet e ndikimeve për secilin grup të prekur; bëni dallimin midis ndikimeve të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta.*
- *Për ndikimet e drejtpërdrejta:*
 - *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet e drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
 - *Analizoni nga ana sasiore ndikimet më të rëndësishme të drejtpërdrejta.*
 - *Përcaktoni vlerën monetare të ndikimeve më të rëndësishme të drejtpërdrejta aty ku është e mundur (shih aneksin 1/a për tabelën që mund të përdorni).*
 - *Analizoni ndikimin mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.*
- *Për ndikimet jo të drejtpërdrejta:*
 - *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet jo të drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
 - *Analizoni ndikimin mbi konkurrencën.*
- *Diskutoni kufizimin e analizës:*
 - *Jepni supozimet në të cilat janë bazuar parashikimet dhe risqet, të cilave ato u nënshtrohen.*
 - *Tregoni sa të forta, të pavarura dhe të rëndësishme janë provat që mbështesin supozimet.*
 - *Tregoni se çfarë mund të pengojë realizimin e përfitimeve, të rrisë kostot ose të sjellë pasoja të papritura.*
- *Përmbledhni vlerësimin e opsioneve:*
 - *Paraqisni një pasqyrë përmbledhëse të të gjitha ndikimeve të opsioneve të analizuara.*
 - *Shpjegoni se si ndikimet e të gjitha opsioneve të analizuara krahasohen me njëra-tjetrën.*

- *Paraqisni përlllogaritjet më të mira të përgjithshme neto të ndikimit me vlerë monetare të përcaktuar për çdo opsion (shih aneksin 1/b për tabelën që mund të përdorni).*

Zbatimi i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9587, datë 20.07.2006, ‘Për mbrojtjen e biodiversitetit’, i ndryshuar”, synon forcimin e kuadrit ligjor kombëtar për mbrojtjen e biodiversitetit dhe përafrimin e tij me kërkesat e acquis të Bashkimit Evropian, veçanërisht me Rregulloren (BE) nr. 511/2014 “Mbi masat e pajtueshmërisë për përdoruesit nga Protokollu i Nagojës për aksesin në burimet gjenetike dhe ndarjen e drejtë dhe të barabartë të përfitimeve që rrjedhin nga përdorimi i tyre”.

Ndërhyrja e propozuar pritet të ketë ndikime institucionale, ekonomike, sociale dhe mjedisore. Ndikimet kryesore lidhen me përmirësimin e kuadrit rregullator për aksesin në burimet gjenetike, rritjen e transparencës dhe gjurmueshmërisë së përdorimit të tyre, forcimin e mekanizmave të monitorimit dhe raportimit, si dhe krijimin e një kuadri më të qartë për institucionet dhe subjektet që lidhen me përdorimin e burimeve biologjike dhe gjenetike. Ndërkohë ky ligj nuk ka implime financiare për buxhetin e shtetit pasi kostot e përlllogarituar janë kostot operacionale të zbatueshmërisë së ligjit nëpërmjet strukturave ekzistuese.

Analiza e ndikimeve është kryer duke identifikuar grupet e prekura, natyrën e ndikimeve të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta, si dhe duke vlerësuar kostot dhe përfitimet e pritshme të ndërhyrjes.

Grupet kryesore të prekura nga ndërhyrja janë:

- a) institucionet publike përgjegjëse për mjedisin, biodiversitetin, zonat e mbrojtura, monitorimin dhe inspektimin;
- b) njësitë e vetëqeverisjes vendore, veçanërisht ato që administrojnë ose kanë në territor zona me vlera të larta natyrore, zona të mbrojtura, habitate apo burime natyrore me rëndësi për biodiversitetin;
- c) administratat e zonave të mbrojtura, të cilat përfshihen në monitorimin, menaxhimin dhe raportimin mbi gjendjen e habitateve, llojeve dhe ekosistemeve;
- ç) institucionet akademike dhe kërkimore, universitetet, qendrat kërkimore dhe laboratorët që mund të përdorin burime gjenetike për qëllime kërkimore, shkencore, arsimore apo zhvillimore;
- d) operatorët ekonomikë që mund të përdorin burime biologjike ose gjenetike, përfshirë sektorët e bujqësisë, pyjeve, peshkimit, farmaceutikës, kozmetikës, bioteknologjisë, produkteve natyrore, bimëve mjekësore dhe aromatike;
- dh) operatorët e turizmit natyror dhe ekoturizmit, të cilët përfitojnë në mënyrë të tërthortë nga ruajtja e biodiversitetit, peizazhit natyror dhe cilësisë së ekosistemeve;
- e) komunitetet lokale dhe rurale, të cilat varen nga burimet natyrore për jetesë, punësim, aktivitete ekonomike tradicionale, turizëm, përdorim të qëndrueshëm të produkteve natyrore dhe mirëqenie;
- ë) shoqëria civile dhe organizatat mjedisore, të cilat kanë rol në monitorim, ndërgjegjësim, pjesëmarrje publike dhe kontroll shoqëror të zbatimit të politikave mjedisore.

Ndikimet institucionale

Ndikimi institucional i projektligjit është i drejtpërdrejtë, pasi ndërhyrja kërkon qartësimin e përgjegjësisë të institucioneve përgjegjëse për administrimin, monitorimin dhe kontrollin e përdorimit të burimeve gjenetike. Institucionet publike do të kenë nevojë të forcojnë kapacitetet për identifikimin e përdoruesve të burimeve gjenetike, ndjekjen e detyrimeve për kujdesin e duhur, administrimin e informacionit, raportimin dhe bashkëpunimin ndërinstitucional.

Për institucionet përgjegjëse, ndikimet kryesore vijnë nga :

- nevoja për përditësimin e procedurave administrative;
- forcimi i mekanizmave të monitorimit dhe raportimit;
- krijimi ose përmirësimi i regjistrave dhe bazave të të dhënave;
- trajnimi i stafit për zbatimin e kërkesave të Rregullores (BE) nr. 511/2014;
- bashkëpunimi me institucione kërkimore, administrata të zonave të mbrojtura dhe përdorues të burimeve gjenetike;
- rritja e transparencës dhe gjurmueshmërisë në përdorimin e burimeve gjenetike.

Këto ndikime nuk krijojnë domosdoshmërisht struktura të reja institucionale, por kërkojnë përdorim më efektiv të strukturave ekzistuese, përmirësim të koordinimit dhe forcim gradual të kapaciteteve teknike.

Ndikimet mbi njësitet e vetëqeverisjes vendore dhe administratat e zonave të mbrojtura

Njësitet e vetëqeverisjes vendore dhe administratat e zonave të mbrojtura preken kryesisht në mënyrë funksionale, pasi ato janë më pranë territorit ku ndodhen habitatet, llojet dhe burimet natyrore që mund të kenë rëndësi për biodiversitetin dhe burimet gjenetike. Ndikimi i projektligjit lidhet me nevojën për përfshirje më të mirë të informacionit mbi biodiversitetin në planifikimin vendor, menaxhimin e zonave të mbrojtura, monitorimin e veprimtarive në terren dhe raportimin e problematikave pranë institucioneve përgjegjëse qendrore.

Për këto struktura, ndikimi pritet të jetë pozitiv, pasi forcimi i kuadrit ligjor mundëson koordinim më të mirë, qartësim të përgjegjësisë dhe përdorim më të mirë të informacionit mjedisor në vendimmarrje. Megjithatë, mund të ketë nevojë për trajnime, udhëzime praktike dhe standardizim të procedurave të raportimit, në mënyrë që zbatimi të jetë i njëtrajtshëm në të gjithë territorin.

Ndikimet ekonomike

Ndikimet ekonomike të projektligjit lidhen kryesisht me përdoruesit e burimeve gjenetike dhe sektorët ekonomikë që mund të kenë interes në përdorimin e tyre. Këtu përfshihen bujqësia, pylltaria, peshkimi, industria farmaceutike, kozmetike, bioteknologjia, kërkimi shkencor, produktet natyrore, bimët mjekësore dhe aromatike, si dhe aktivitete të tjera që mbështeten në burime biologjike dhe gjenetike.

Ndërhyrja nuk synon të kufizojë përdorimin ekonomik të burimeve gjenetike, por ta vendosë atë në një kuadër më të qartë, më transparent dhe më të gjurmueshëm ligjor. Për operatorët ekonomikë, ndikimet pozitive lidhen me rritjen e sigurisë juridike, qartësimin e rregullave të aksesit, uljen e pasigurisë administrative dhe krijimin e kushteve për përdorim të ligjshëm e të qëndrueshëm të burimeve gjenetike.

Në të njëjtën kohë, disa subjekte që përdorin burime gjenetike mund të përballen me një barrë të kufizuar administrative, të lidhur me dokumentimin e origjinës së burimeve, ruajtjen e informacionit, deklarimin e përdorimit, përmbushjen e detyrimeve për kujdesin e duhur dhe bashkëpunimin me autoritetet përgjegjëse. Në këtë fazë, këto kosto nuk mund të përlllogariten në mënyrë të besueshme, qoftë edhe përafërsisht, për shkak të mungesës së të dhënave bazë për numrin dhe kategoritë e subjekteve që do t'u nënshtrohen konkretisht detyrimeve, shpeshtësinë e procedurave, kohën mesatare të nevojshme për përmbushjen e tyre dhe kostot përkatëse të punës. Gjithashtu, për subjektet që tashmë zbatojnë procedura dokumentimi dhe gjurmueshmërie, një pjesë e këtyre veprimeve mund të përmbushet përmes sistemeve dhe personelit ekzistues, pa krijuar kosto shtesë të dallueshme. Për këto arsye, paraqitja e një vlere monetare të përafërt, pa të dhëna të verifikueshme, do të krijonte rrezik të lartë mbivlerësimi ose nënvlerësimi. Këto ndikime trajtohen në mënyrë cilësore në këtë RIA dhe do të rivlerësohen gjatë zbatimit, pasi të jenë identifikuar subjektet e prekura dhe të jenë mbledhur të dhëna për numrin e procedurave, kohën administrative dhe kostot faktike të pajtueshmërisë.

Ndikimi mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme

Ndikimi mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme pritet të jetë i kufizuar dhe kryesisht administrativ. Projektligji nuk parashikon vendosjen e taksave apo tarifave të reja të drejtpërdrejta për SME-të, por mund të krijojë detyrime të caktuara për përputhshmëri në rastet kur këto ndërmarrje përdorin burime gjenetike për qëllime tregtare, kërkimore apo zhvillimore. Për SME-të që operojnë në sektorë si bimët mjekësore dhe aromatike, produktet natyrore, bujqësia, kozmetika, bioteknologjia apo kërkimi i aplikuar, ndikimi kryesor lidhet me nevojën për të dokumentuar përdorimin e burimeve gjenetike dhe për të respektuar kërkesat për kujdesin e duhur. Për të shmangur barrën e panevojshme rregullatore, aktet nënligjore dhe udhëzimet zbatuese duhet të parashikojnë procedura të thjeshta, proporcionale dhe të kuptueshme, veçanërisht për ndërmarrjet e vogla dhe përdoruesit me kapacitete të kufizuara administrative.

Në afatmesëm dhe afatgjatë, qartësimi i rregullave mund të ketë ndikim pozitiv për SME-të, pasi rrit sigurinë juridike, përmirëson aksesin në tregje që kërkojnë standarde të gjurmueshmërisë dhe qëndrueshmërisë, si dhe krijon mundësi për pjesëmarrje në projekte kërkimore, inovative dhe të ekonomisë së gjelbër.

Ndikimet mbi punësimin

Ndikimi i drejtpërdrejtë mbi punësimin nuk pritet të jetë i menjëhershëm dhe i lartë në terma sasiorë, pasi projektligji nuk krijon domosdoshmërisht struktura të reja të mëdha institucionale. Megjithatë, në mënyrë të tërthortë, zbatimi i tij mund të krijojë nevojë për kapacitete të specializuara në administratën publike, institucionet kërkimore, monitorimin mjedisor, menaxhimin e të dhënave, vlerësimin e biodiversitetit dhe sektorët që përdorin burime gjenetike.

Në afatmesëm, ndikimi mbi punësimin mund të jetë pozitiv, veçanërisht në sektorë si kërkimi shkencor, monitorimi i biodiversitetit, ekoturizmi, bujqësia e qëndrueshme, produktet natyrore dhe shërbimet mjedisore. Ky ndikim varet nga zbatimi praktik i ligjit, niveli i financimit, zhvillimi i projekteve të lidhura me biodiversitetin dhe përfshirja e komuniteteve lokale.

Ndikimet sociale

Ndikimet sociale të projektligjit lidhen kryesisht me komunitetet lokale dhe rurale, të cilat jetojnë pranë zonave me vlera të larta natyrore dhe shpesh varen nga burimet natyrore për të ardhurat, punësimin, turizmin, bujqësinë, pyjet, peshkimin apo përdorimin tradicional të produkteve natyrore.

Ndërhyrja pritet të ketë ndikim pozitiv mbi mirëqenien sociale, pasi ruajtja e biodiversitetit dhe përdorimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore kontribuojnë në mbrojtjen e bazës natyrore të jetesës së komuniteteve. Përmirësimi i menaxhimit të biodiversitetit mund të ndikojë pozitivisht në cilësinë e mjedisit, zhvillimin e turizmit natyror, mundësitë për punësim lokal, ruajtjen e njohurive tradicionale dhe përfshirjen më të madhe të komuniteteve në vendimmarrje.

Projektligji mund të ndikojë edhe në barazinë territoriale, pasi zonat rurale dhe zonat me vlera të larta natyrore shpesh kanë nevojë për më shumë mbështetje institucionale, informacion dhe mundësi zhvillimi të qëndrueshëm. Forcimi i kuadrit ligjor për biodiversitetin mund të kontribuojë në një shpërndarje më të drejtë të përfitimeve që lidhen me përdorimin e burimeve gjenetike dhe shërbimeve të ekosistemit.

Ndikimet mbi shëndetin publik

Ndikimet mbi shëndetin publik janë kryesisht të tërthorta. Ruajtja e biodiversitetit, mbrojtja e ekosistemeve dhe përdorimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore ndikojnë në cilësinë e ajrit, ujit, tokës, sigurinë ushqimore dhe qëndrueshmërinë e ekosistemeve që mbështesin shëndetin e popullsisë. Biodiversiteti ka rëndësi edhe për kërkimin shkencor dhe zhvillimin e produkteve me përdorim potencial në fushat farmaceutike, mjekësore dhe bioteknologjike.

Për këtë arsye, ndërhyrja pritet të ketë ndikim pozitiv afatgjatë mbi shëndetin publik, përmes forcimit të mekanizmave për mbrojtjen e burimeve natyrore dhe përdorimin e tyre në mënyrë të kontrolluar, transparente dhe të qëndrueshme.

Pjesëmarrja publike

Projektligji pritet të ndikojë pozitivisht në pjesëmarrjen publike, pasi forcimi i kuadrit për biodiversitetin kërkon më shumë transparencë, informim dhe përfshirje të palëve të interesit. Organizatat e shoqërisë civile, institucionet akademike, komunitetet lokale dhe operatorët ekonomikë kanë interes të drejtpërdrejtë në proceset që lidhen me menaxhimin e biodiversitetit, aksesin në burimet gjenetike dhe ndarjen e përfitimeve.

Pjesëmarrja publike është e rëndësishme jo vetëm gjatë konsultimit të projektligjit, por edhe në fazën e zbatimit, veçanërisht për hartimin e akteve nënligjore, përcaktimin e procedurave praktike, raportimin mbi gjendjen e biodiversitetit dhe monitorimin e ndikimeve në terren.

Ndikimet mjedisore

Ndikimet mjedisore të projektligjit pritet të jenë pozitive, veçanërisht në afatmesëm dhe afatgjatë. Situata bazë karakterizohet nga presione të vazhdueshme mbi biodiversitetin, përfshirë degradimin e habitateve, përdorimin e paqëndrueshëm të burimeve natyrore, fragmentimin e ekosistemeve, ndikimet nga ndryshimet klimatike, ndotjen, urbanizimin, zhvillimet infrastrukturore dhe mungesën e të dhënave të plota e të standardizuara për gjendjen e biodiversitetit.

Ndërhyrja synon të përmirësojë këtë situatë duke forcuar mekanizmat ligjorë për mbrojtjen, monitorimin dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve gjenetike dhe biodiversitetit. Përfitimet mjedisore pritet të përfshijnë:

- përmirësimin e gjurmueshmërisë së përdorimit të burimeve gjenetike;
- forcimin e monitorimit të biodiversitetit;
- rritjen e transparencës në administrimin e të dhënave;
- mbështetjen e ruajtjes së habitateve dhe llojeve;
- forcimin e zbatimit të parimit të përdorimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore;
- rritjen e përputhshmërisë me standardet e BE-së dhe detyrimet ndërkombëtare.

Treguesit që mund të përdoren për të matur ndikimin mjedisor përfshijnë numrin e rasteve të monitoruara të përdorimit të burimeve gjenetike, numrin e përdoruesve të regjistruar, numrin e kontroleve të përputhshmërisë, numrin e raporteve periodike për biodiversitetin, përditësimin e bazave të të dhënave, numrin e habitateve dhe llojeve të monitoruara, si dhe numrin e masave të ndërmarra për ruajtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të biodiversitetit.

Kostoja e mosndërhyrjes

Mosndërhyrja do të ruante paqartësitë ekzistuese në kuadrin ligjor dhe institucional për aksesin në burimet gjenetike dhe ndarjen e përfitimeve. Kjo do të sillte rrezik për përdorim të paqartë, të pakoordinuar ose të pagjurmueshëm të burimeve gjenetike, mungesë sigurie juridike për përdoruesit, vështirësi në monitorim dhe raportim, si dhe vonesa në përafrimin me acquis të Bashkimit Evropian.

Në aspektin mjedisor, mosndërhyrja mund të ndikojë negativisht në ruajtjen afatgjatë të biodiversitetit dhe shërbimeve të ekosistemit. Në aspektin ekonomik, mungesa e rregullave të qarta mund të ulë mundësitë për zhvillimin e kërkimit shkencor, inovacionit, produkteve natyrore dhe investimeve të gjelbra. Në aspektin institucional, mosndërhyrja do të ruante fragmentimin e të dhënave, raportimit dhe përgjegjësiive ndërmjet institucioneve.

Ndikimet jo të drejtpërdrejta

Ndikimet jo të drejtpërdrejta lidhen me zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, rritjen e investimeve të gjelbra, përmirësimin e konkurrueshmërisë afatgjatë dhe mbështetjen e

sektorëve që bazohen në përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore. Përmirësimi i kuadrit ligjor për biodiversitetin dhe ABS mund të nxisë kërkimin shkencor, inovacionin, zhvillimin e produkteve me bazë natyrore dhe bashkëpunimin ndërmjet institucioneve publike, akademisë dhe sektorit privat.

Në afatgjatë, këto ndikime mund të kontribuojnë në rritjen e vlerës ekonomike të biodiversitetit, zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm, forcimin e reputacionit të vendit në fushën e mbrojtjes së natyrës dhe përmirësimin e aksesit në programe e financime të Bashkimit Evropian.

Ndikimi mbi konkurrencën

Projektligji nuk krijon barriera të drejtpërdrejta për hyrjen në treg dhe nuk vendos kufizime të pajustificuara mbi aktivitetin ekonomik. Përkundrazi, ai synon të krijojë kushte më të qarta dhe më të barabarta për të gjithë përdoruesit e burimeve gjenetike, duke rritur transparencën dhe sigurinë juridike.

Ndikimi mbi konkurrencën pritet të jetë pozitiv në afatgjatë, pasi subjektet që respektojnë kërkesat ligjore dhe standardet e qëndrueshmërisë do të operojnë në një mjedis më të rregulluar dhe më të parashikueshëm. Megjithatë, për të shmangur barrën e tepërt mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, zbatimi duhet të mbështetet në procedura proporcionale, udhëzime të qarta dhe mbështetje institucionale.

Kufizimet e analizës

Analiza mbështetet në informacionin ekzistues mbi gjendjen e biodiversitetit, funksionimin e institucioneve përgjegjëse dhe kërkesat e përafrimit me Rregulloren (BE) nr. 511/2014. Një kufizim i rëndësishëm lidhet me mungesën e të dhënave të plota sasiore për numrin e përdoruesve potencialë të burimeve gjenetike, kostot administrative të përputhshmërisë, vlerën ekonomike të shërbimeve të ekosistemit dhe përfitimet monetare që mund të burojnë nga ruajtja më e mirë e biodiversitetit.

Për shkak të natyrës së ndërhyrjes, disa ndikime janë më lehtë të vlerësueshme në mënyrë cilësore sesa monetare. Përfitimet që lidhen me ruajtjen e biodiversitetit, shërbimet e ekosistemit, shëndetin publik, mirëqenien sociale dhe zhvillimin e qëndrueshëm kanë karakter afatgjatë dhe shpesh nuk mund të monetizohen plotësisht në fazën e hartimit të projektligjit.

Megjithatë, mungesa e monetizimit të plotë nuk e ul rëndësinë e ndërhyrjes, pasi përfitimet institucionale, mjedisore dhe sociale janë të rëndësishme për procesin e integritetit evropian, zbatimin e detyrimeve ndërkombëtare dhe mbrojtjen afatgjatë të kapitalit natyror të vendit.

Përmbledhje e vlerësimit të opsioneve

Opsioni i mosndërhyrjes ruan situatën ekzistuese, por nuk adreson boshllëqet ligjore dhe institucionale për aksesin në burimet gjenetike, ndarjen e përfitimeve, monitorimin dhe raportimin. Ky opsion ka kosto më të ulët administrative në afatshkurtër, por kosto më të lartë në afatgjatë për shkak të mungesës së përafrimit me BE-në, pasigurisë juridike dhe rrezikut për përdorim të paqëndrueshëm të burimeve gjenetike.

Opsioni i ndërhyrjes së pjesshme përmes akteve nënligjore mund të përmirësojë disa procedura, por nuk garanton bazë të mjaftueshme ligjore për përafrimin me Rregulloren (BE) nr. 511/2014 dhe për përcaktimin e qartë të detyrimeve të përdoruesve dhe përgjegjësive institucionale.

Opsioni i preferuar, ndryshimi i ligjit për mbrojtjen e biodiversitetit, krijon bazën më të përshtatshme ligjore për përafrimin me Rregulloren (BE) nr. 511/2014, forcimin e mekanizmave të monitorimit dhe raportimit, rritjen e sigurisë juridike dhe mbrojtjen më efektive të biodiversitetit. Ky opsion ka kosto të moderuara administrative dhe institucionale, por përfitime më të larta afatmesme dhe afatgjata në aspektin mjedisor, social, ekonomik dhe të integritetit evropian.

.

Institucionet publike

Vlerësimi i ndikimit financiar dhe administrativ

Zbatimi i opsionit 3 nuk parashikon kosto shtesë mbi buxhetin e shtetit.

Projektligji nuk krijon institucione të reja, struktura të reja administrative apo detyrime të reja buxhetore të drejtpërdrejta në momentin e miratimit të tij. Ndërhyrja ka kryesisht natyrë rregullatore dhe përafruese me acquis të Bashkimit Evropian, duke synuar qartësimin e procedurave dhe përgjegjësiwe ekzistuese për aksesin në burimet gjenetike, ndarjen e përfitimeve dhe detyrimet e përdoruesve për kujdesin e duhur.

Për këtë arsye, kostot administrative shtesë vlerësohen si **të ulëta dhe të përballueshme brenda kapaciteteve ekzistuese institucionale**. Ato lidhen kryesisht me kohën e stafit për shqyrtimin e dokumentacionit, administrimin e informacionit, komunikimin ndërinstitutional dhe përgatitjen e raportimeve. Këto veprimtari janë të lidhura me funksionet ekzistuese të institucioneve përgjegjëse për biodiversitetin, monitorimin, kontrollin dhe raportimin mjedisor, ndaj nuk krijojnë nevojë të menjëhershme për financim shtesë.

Edhe nevojat për trajnim nuk konsiderohen si kosto e re e drejtpërdrejtë në fazën e miratimit të ligjit. Trajnimet për zbatimin e kërkesave të Rregullores (BE) nr. 511/2014, për kujdesin e duhur, gjurmueshmërinë e burimeve gjenetike, monitorimin dhe raportimin mund të realizohen gradualisht përmes programeve ekzistuese të ngritjes së kapaciteteve, asistencës teknike, projekteve të donatorëve ose planifikimit të zakonshëm institucional. Për rrjedhojë, ndikimi financiar i tyre në momentin e miratimit të ligjit është **zero**, ndërsa ndikimi organizativ është **i kufizuar dhe gradual**.

Sa i përket monitorimit, projektligji nuk parashikon ngritjen e një mekanizmi të ri monitorimi me kosto të veçantë buxhetore, por mbështetet në strukturat ekzistuese që ushtrojnë funksione monitorimi dhe kontrolli në fushën e biodiversitetit dhe mjedisit. Në mënyrë cilësore, ndikimi lidhet me përmirësimin e koordinimit, standardizimin e praktikave dhe përdorimin më të mirë të informacionit ekzistues. Në mënyrë sasiore, në fazën e miratimit të ligjit nuk identifikohet kosto shtesë e drejtpërdrejtë, pasi monitorimi do të kryhet nga kapacitetet aktuale.

Në lidhje me databazat, projektligji nuk kërkon domosdoshmërisht krijimin e një sistemi të ri elektronik menjëherë pas miratimit të tij. Administrimi i të dhënave mund të realizohet fillimisht përmes bazave ekzistuese të të dhënave, regjistrave administrativë dhe praktikave aktuale të raportimit. Çdo përmirësim i mëtejshëm teknik, përfshirë krijimin e moduleve të posaçme apo ndërveprueshmërinë me sisteme të tjera, do të vlerësohet në fazën e hartimit të akteve nënligjore dhe të zbatimit praktik, në varësi të nevojave konkrete dhe burimeve të disponueshme.

Raportimi sipas acquis gjithashtu nuk krijon kosto të menjëhershme shtesë me miratimin e projektligjit. Në fazën fillestare, raportimi do të mbështetet në strukturat dhe mekanizmat ekzistues të raportimit mjedisor. Nevoja për standardizim të mëtejshëm të formateve, përmirësim të cilësisë së të dhënave dhe harmonizim me kërkesat e BE-së do të trajtohet gradualisht, në kuadër të procesit të integritit evropian dhe të detyrimeve ekzistuese të institucioneve përgjegjëse.

Në këtë kuptim, analiza cilësore tregon se ndikimet mbi institucionet publike janë kryesisht administrative, teknike dhe organizative, ndërsa analiza sasiore në këtë fazë vlerëson se **kostoja shtesë e drejtpërdrejtë për buxhetin e shtetit në momentin e miratimit të ligjit është 0 lekë**. Çdo nevojë e mëtejshme për trajnim, monitorim, përmirësim databazash apo raportim të avancuar do të vlerësohet në fazat pasuese të zbatimit, pa e lidhur miratimin e ligjit me një efekt financiar të menjëhershëm.

• Elementi	• Vlerësimi cilësor	• Vlerësimi sasior në momentin e miratimit
• Kosto administrative shtesë	• Përshtatje e procedurave dhe koordinim ndërinstitucional	• 0 lekë kosto shtesë direkte; përballohet nga strukturat ekzistuese
• Nevoja për trajnim	• Trajnime graduale për ABS, kujdesin e duhur dhe raportimin	• 0 lekë në momentin e miratimit; mund të mbulohet nga programet ekzistuese/donatorët
• Kosto monitorimi	• Përmirësim i monitorimit përmes strukturave ekzistuese	• 0 lekë kosto shtesë direkte në fazën fillestare
• Databaza	• Përdorim/përshtatje graduale e sistemeve ekzistuese	• Nuk kërkohet sistem i ri menjëherë; 0 lekë në miratim
• Raportimi sipas acquis	• Standardizim gradual i raportimit	• 0 lekë kosto shtesë direkte; realizohet përmes mekanizmave ekzistues
	•	•

Biznesi / sektori privat

- Qartësim i procedurave për aksesin në burimet gjenetike (ABS).
- Rritje e sigurisë juridike për aktivitetet kërkimore dhe ekonomike.
- Për disa subjekte, rritje e kërkesave për përputhshmëri (compliance), por pa barrë të re fiskale.

Shoqëria civile dhe institucionet kërkimore

- Rritje e aksesit në të dhëna dhe transparencë më e madhe.
- Mundësi më të mira për monitorim dhe pjesëmarrje në proceset e politikave mjedisore.

Qytetarët dhe komunitetet lokale

- Përmirësim i cilësisë së mjedisit dhe ruajtjes së burimeve natyrore.
- Përfitime afatgjata nga shërbimet e ekosistemit (uji, toka, biodiversiteti).

Analiza e ndikimeve sipas sektorëve të prekur

Ndërhyrja e propozuar nuk parashikon vendosjen e kostove shtesë të drejtpërdrejta për sektorët ekonomikë, bizneset apo përdoruesit e burimeve natyrore. Ndikimet pritet të jenë kryesisht cilësore dhe të lidhura me rritjen e qartësisë ligjore, përmirësimin e menaxhimit të biodiversitetit, përdorimin më të qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe forcimin e sigurisë

juridike për subjektet që veprojnë në sektorë të lidhur me natyrën dhe burimet biologjike

Turizmi

Sektori i turizmit, veçanërisht turizmi natyror, ekoturizmi dhe turizmi në zonat e mbrojtura, ndikohet pozitivisht nga ruajtja e biodiversitetit, habitateve natyrore dhe peizazheve me vlerë natyrore. Një kuadër më i qartë për mbrojtjen dhe monitorimin e biodiversitetit ndihmon në ruajtjen e cilësisë së destinacioneve natyrore, duke mbështetur zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit. Nuk parashikohen kosto shtesë të drejtpërdrejta për operatorët turistikë, por mund të ketë nevojë për respektim më të mirë të standardeve ekzistuese mjedisore në zonat me ndjeshmëri të lartë natyrore.

Bujqësia

Bujqësia ndikohet nga gjendja e biodiversitetit përmes shërbimeve të ekosistemit, si pjalmimi, ruajtja e pjellorisë së tokës, kontrolli natyror i dëmtuesve dhe menaxhimi i burimeve ujore. Mbrojtja më efektive e biodiversitetit kontribuon në qëndrueshmërinë afatgjatë të prodhimit bujqësor. Ndërhyrja nuk vendos kosto të reja për fermerët, por nxit përdorimin më të qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe reduktimin e presioneve mbi habitatet dhe llojet e egra.

Pyjet

Pyjet janë një nga ekosistemet më të rëndësishme për ruajtjen e biodiversitetit dhe për ofrimin e shërbimeve të ekosistemit, përfshirë mbrojtjen nga erozioni, ruajtjen e ujërave, sekuestrimin e karbonit dhe habitatet për florën dhe faunën e egër. Ndikimi mbi sektorin e pyjeve pritet të jetë pozitiv, pasi përmirësimi i monitorimit dhe mbrojtjes së biodiversitetit mbështet menaxhimin më të qëndrueshëm të fondit pyjor. Nuk parashikohen kosto shtesë të drejtpërdrejta, por kërkohet zbatim më i koordinuar i detyrimeve ekzistuese për mbrojtjen e habitateve pyjore.

Peshkimi

Peshkimi dhe akuakultura lidhen drejtpërdrejt me gjendjen e ekosistemeve ujore, lagunave, lumenjve, liqeneve dhe zonave bregdetare. Mbrojtja e biodiversitetit ndihmon në ruajtjen e habitateve ujore, popullatave të llojeve vendase dhe ekuilibrave ekologjikë që mbështesin burimet peshkore. Ndërhyrja nuk parashikon barrë të re financiare për subjektet e peshkimit, por mund të ndikojë pozitivisht në qëndrueshmërinë afatgjatë të burimeve natyrore nga të cilat varet ky sektor.

Industria farmaceutike dhe bioteknologjia

Industria farmaceutike dhe bioteknologjia mund të preken në rastet kur përdoren burime biologjike ose gjenetike për kërkim, zhvillim produktesh apo veprimtari ekonomike. Një kuadër më i qartë për aksesin në burimet gjenetike dhe ndarjen e përfitimeve rrit sigurinë juridike, transparencën dhe parashikueshmërinë për këto subjekte. Ndërhyrja nuk synon të kufizojë aktivitetin ekonomik, por të sigurojë që përdorimi i burimeve gjenetike të kryhet në mënyrë të rregullt, transparente dhe në përputhje me detyrimet ndërkombëtare.

Aktivitetet kërkimore

Institucionet akademike, kërkimore dhe ekspertët e biodiversitetit ndikohen kryesisht përmes përmirësimit të aksesit në të dhëna, standardizimit të metodologjive të monitorimit dhe qartësimin të procedurave për përdorimin e burimeve biologjike dhe gjenetike. Kjo pritet të

rrisë cilësinë e kërkimit shkencor dhe përdorimin e rezultateve të tij në vendimmarrje. Nuk parashikohen kosto shtesë të drejtpërdrejta për aktivitetet kërkimore, por kërkohet respektimi i procedurave përkatëse kur kërkimi lidhet me burime gjenetike ose me zona e lloje të mbrojtura.

Investimet private

Investimet private që lidhen me turizmin, bujqësinë, pyjet, përdorimin e burimeve natyrore, kërkimin shkencor apo sektorë të tjerë me ndikim në biodiversitetet përfitojnë nga një kuadër më i qartë dhe më i parashikueshëm. Qartësimi i rregullave ndihmon në uljen e pasigurisë juridike dhe në orientimin e investimeve drejt modeleve më të qëndrueshme. Ndërhyrja nuk vendos kosto të reja të drejtpërdrejta për investitorët privatë, por kërkon që veprimtaritë të jenë në përputhje me standardet e mbrojtjes së biodiversitetit dhe përdorimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore.

Pronësia dhe përdorimi i tokës

Ndërhyrja nuk cenon të drejtën e pronësisë dhe nuk parashikon ndryshime në regjimin e pronësisë mbi tokën. Ndikimi lidhet kryesisht me mënyrën e përdorimit të tokës në rastet kur ajo ndodhet në zona me vlera të larta natyrore, pranë habitateve të mbrojtura ose në territore ku veprimtaritë mund të ndikojnë mbi biodiversitetin. Në këto raste, përdorimi i tokës duhet të jetë në përputhje me legjislacionin ekzistues mjedisor, planifikimin territorial dhe kërkesat për mbrojtjen e natyrës. Për rrjedhojë, ndikimi mbi pronësinë vlerësohet neutral, ndërsa ndikimi mbi përdorimin e tokës lidhet me orientimin drejt përdorimit të qëndrueshëm dhe shmangien e dëmtimit të habitateve dhe llojeve.

Në përfundim, ndikimet sektoriale vlerësohen kryesisht pozitive ose neutrale. Ndërhyrja nuk krijon kosto shtesë të drejtpërdrejta për sektorët e analizuar, por kontribuon në rritjen e qartësisë, përmirësimin e administrimit të burimeve natyrore, ruajtjen e shërbimeve të ekosistemit dhe forcimin e zhvillimit të qëndrueshëm.

Ndikimi mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (SME)

Ndërhyrja nuk parashikon vendosjen e detyrimeve të reja financiare apo administrative për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Për këtë arsye, ndikimi i drejtpërdrejtë mbi SME-të vlerësohet neutral.

SME-të që mund të preken në mënyrë të tërthortë janë kryesisht ato që ushtrojnë veprimtari në sektorë të lidhur me përdorimin e burimeve natyrore, si turizmi natyror, bujqësia, pyjet, peshkimi, aktivitetet kërkimore, bioteknologjia ose përdorimi i burimeve biologjike dhe gjenetike. Numri i saktë i SME-ve të prekura nuk mund të përcaktohet në këtë fazë, pasi ndërhyrja nuk krijon një regjim të ri licencimi, raportimi apo detyrimi të përgjithshëm për të gjitha SME-të, por lidhet vetëm me subjekte që ushtrojnë veprimtari të veçanta me ndikim ose lidhje të drejtpërdrejta me biodiversitetin.

Sa i përket kostove të përshtatjes, nuk parashikohen kosto shtesë të drejtpërdrejta për SME-të. Përshtatja, në rastet kur është e nevojshme, lidhet me respektimin e kërkesave ekzistuese mjedisore dhe me zbatimin e praktikave të qëndrueshme në përdorimin e burimeve natyrore.

Kostot e raportimit për SME-të vlerësohen neutrale, pasi ndërhyrja nuk parashikon vendosjen e detyrimeve të reja të përgjithshme raportimi për bizneset. Raportimi sipas *acquis* dhe monitorimi i biodiversitetit mbeten përgjegjësi e institucioneve publike kompetente.

Edhe kostot administrative për SME-të vlerësohen të papërfillshme ose neutrale, pasi nuk parashikohet krijimi i procedurave të reja administrative të përgjithshme për ndërmarrjet. Në rastet kur subjekte të caktuara përdorin burime gjenetike ose zhvillojnë veprimtari në zona me vlera të larta natyrore, ndikimi lidhet kryesisht me qartësimin e procedurave dhe rritjen e sigurisë juridike, jo me krijimin e barrës së re administrative.

Në përfundim, ndërhyrja nuk pritet të krijojë kosto shtesë për SME-të. Ndikimi kryesor mbi këtë kategori është indirekt dhe lidhet me përmirësimin e qartësisë ligjore, mbrojtjen e burimeve natyrore dhe krijimin e kushteve më të qëndrueshme për zhvillimin e veprimtarive ekonomike që varen nga biodiversiteti dhe shërbimet e ekosistemeve.

Ndikimet cilësore jo të drejtpërdrejta

Ekonomia dhe zhvillimi i qëndrueshëm

- Ruajtje afatgjatë e kapitalit natyror.
- Mbështetje për turizmin natyror dhe ekonominë e gjelbër.
- Ulje e kostove të ardhshme të restaurimit të mjedisit.

Mjedisi

- Përmirësim i statusit të habitateve dhe llojeve.
- Reduktim i rrezikut nga llojet invazive.
- Forcim i lidhshmërisë ekologjike.

Shoqëria

- Rritje e ndërgjegjësimit publik për biodiversitetin.
- Përmirësim i cilësisë së jetës në komunitetet lokale.

Ndikimi mbi konkurrencën

- Ndërhyrja nuk krijon barriera të reja të drejtpërdrejta në treg.
- Rritja e kërkesave të përputhshmërisë mund të ndikojë në mënyrë të moderuar bizneset që përdorin burime gjenetike.
- Në afatgjatë:
 - përmirëson konkurrueshmërinë e sektorëve që operojnë në mënyrë të qëndrueshme;
 - rrit aksesin në tregje dhe fonde ndërkombëtare për subjektet e përputhshme me standardet e BE-së.

Krahasimi i opsioneve

- **Opsioni 0 (status quo):** Nuk adreson problemet; mospërputhje e vazhdueshme me BE-në; ndikim neto negativ afatgjatë.
- **Opsioni 1:** Përmirësim i kufizuar; ndikim pozitiv i pjesshëm; nuk zgjidh problemet strukturore.
- **Opsioni 2 :** Ndikim potencial pozitiv, por i kufizuar; rrezik tranzicioni.
- **Opsioni 3 (i preferuar):** Ndikim pozitiv i lartë afatgjatë; përafrim me BE; përmirësim institucional dhe mjedisor; kosto e ulët neto.
- Opsioni 4: Ndikim potencial pozitiv, por me kosto dhe vonesa më të larta; rrezik tranzicioni dhe mungesë proporcionaliteti krahasuar me amendimin e ligjit ekzistues.
-

Opsioni 3 rezulton më i favorshmi në terma të balancës midis kostove, përfitimeve dhe zbatueshmërisë institucionale. Ai siguron përfitimet më të mëdha neto afatgjata, veçanërisht në

aspektin e ruajtjes së biodiversitetit, përafrimit me BE-në dhe forcimit institucional, duke ruajtur një nivel të ulët të barrës financiare direkte.

Arsyetimi i opsionit të preferuar

- Zgjidhni opsionin e preferuar, bazuar në analizë.
- Shpjegoni arsyetimin tuaj.

Bazuar në analizën e opsioneve të shqyrtuara dhe vlerësimin e ndikimeve, si opsion i preferuar është përzgjedhur **Opsioni 3 – Amendimi i ligjit ekzistues nr. 9587/2006 “Për mbrojtjen e biodiversitetit”**.

Opsioni 3 është vlerësuar si alternativa më e përshtatshme, efektive dhe proporcionale, pasi siguron balancën më të mirë midis nevojës për reformë ligjore, kapaciteteve institucionale dhe detyrimeve të integritetit evropian.

Një ndërhyrje ligjore është e përshtatshme sepse:

- boshllëqet kryesore janë normative dhe institucionale, jo vetëm të zbatimit praktik;
- kërkohet përafrim i drejtpërdrejtë me direktiva të BE-së, i cili nuk mund të arrihet plotësisht përmes akteve nënligjore;
- nevojitet krijimi i bazës ligjore për ABS dhe përforcimi i mekanizmave të monitorimit;
- kërkohet qartësim i përgjegjësisë institucionale në nivel ligjor.

Për këtë arsye, ndryshimi i ligjit ekzistues (Opsioni 3) vlerësohet si instrumenti më i përshtatshëm, proporcional dhe efektiv për adresimin e problemit.

Arsyet kryesore janë:

1. Përafrimi i plotë me acquis të BE-së

Ky opsion mundëson harmonizimin e drejtpërdrejtë të legjislacionit kombëtar me:

- Direktivën 92/43/KEE (Habitatet);
- Direktivën 2009/147/KE (Shpendët e egra);
- Rregulloren (BE) nr. 511/2014 dhe Protokollin e Nagojës (ABS).

Kjo është thelbësore për përmbushjen e detyrimeve në kuadër të Kapitullit 27 – Mjedisi dhe Ndryshimet Klimatike.

2. Zgjidh problemet kryesore të identifikuara

Opsioni 2 adreson në mënyrë të plotë boshllëqet ekzistuese në:

- monitorim dhe raportim të biodiversitetit;
- mbrojtjen dhe menaxhimin e habitateve;
- kontrollin e llojeve invazive;
- aksesin në burimet gjenetike dhe ndarjen e përfitimeve (ABS);
- qartësimin e përgjegjësisë institucionale.

3. Efikasitet dhe proporcionalitet

- Nuk kërkon krijimin e strukturave të reja institucionale;
- Përdor kapacitetet ekzistuese shtetërore;
- Ka kosto të ulët financiare për buxhetin e shtetit;
- Ofron përfitime të larta afatgjata mjedisore dhe ekonomike.

4. Zbatim më i shpejtë dhe më realist

Ndryshe nga opsioni i hartimit të një ligji të ri, që është Opsioni 4 i cili parashikon zëvendësimin e ligjit aktual me një kuadër të ri ligjor të plotë për biodiversitetin duke krijuar mundësi për riorganizim të plotë të kuadrit ligjor; të integrojë në mënyrë tërësore të gjitha kërkesat e reja kombëtare dhe evropiane; dhe të shmangë fragmentimin e dispozitave

ekzistuese, por që kërkon kohë më të gjatë për hartim, konsultim dhe miratim; mund të sjellë kosto më të larta administrative; mund të krijojë pasiguri gjatë periudhës së tranzicionit; dhe nuk është proporcional nëse problematikat mund të adresohen përmes ndryshimit të ligjit ekzistues.

Opsioni i preferuar është opsioni 3 i cili

- mund të zbatohet më shpejt;
- shmang vonesat e procesit legjislativ të plotë;
- minimizon rrezikun e boshllëqeve ligjore gjatë tranzicionit.

5. Ndikim pozitiv i balancuar

Opsioni i përzgjedhur siguron:

- përmirësim të ndjeshëm të mbrojtjes së biodiversitetit;
- forcim të kapaciteteve institucionale;
- rritje të transparencës dhe efektivitetit të zbatimit;
- mbështetje për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik.

Përpara përzgjedhjes së opsionit të preferuar, është kryer një analizë me shumë kriteret për të krahasuar opsionet e shqyrtuara në mënyrë sa më objektive dhe të strukturuar. Analiza vlerëson shkallën në të cilën secili opsion adreson problemin, përmbush objektivat e politikës, siguron përafrim me acquis të BE-së, është i zbatueshëm nga institucionet ekzistuese dhe nuk krijon barrë të panevojshme financiare apo administrative. Kriteret e përdorura dhe pesha përkatëse janë: efektiviteti në adresimin e problemit – 30%; përafrimi me acquis të BE-së – 25%; zbatueshmëria institucionale – 15%; ndikimi financiar dhe administrativ – 15%; dhe ndikimi mjedisor e socio-ekonomik – 15%. Kjo analizë shërben për të evidentuar opsionin që ofron balancën më të mirë ndërmjet efektivitetit, proporcionalitetit, zbatueshmërisë dhe ndikimeve të pritshme.

Opsioni 0 – Mosveprimi / ruajtja e kuadrit ekzistues.

Opsioni 1 – Përmirësim vetëm përmes udhëzimeve administrative/praktikave institucionale.

Opsioni 2 – Ndryshimi dhe plotësimi i akteve nënligjore ekzistuese.

Opsioni 3 – Ndryshimi i ligjit për mbrojtjen e biodiversitetit, si opsion i preferuar.

Opsioni 4 – Miratimi i një ligji të ri të posaçëm / ndërhyrje më e gjerë rregullatore.

Kriteret	Pesha	Opsioni 0	Opsioni 1	Opsioni 2 – ndryshimi i akteve nënligjore	Opsioni 3	Opsioni 4
Efektiviteti në mbrojtjen dhe ruajtjen e biodiversitetit	5	1 (5)	2 (10)	3 (15)	5 (25)	4 (20)
Efektiviteti në forcimin e sistemit të monitorimit dhe raportimit	4	1 (4)	2 (8)	3 (12)	4 (16)	4 (16)
Efektiviteti në	4	1 (4)	2 (8)	3 (12)	4 (16)	4 (16)

menaxhimin e llojeve jo vendase dhe invazive						
Efektiviteti ne zbatimin e sistemit te aksesit ne burimet gjenetike dhe ndarjes se perfitimeve (ABS)	4	1 (4)	2 (8)	3 (12)	5 (20)	4 (16)
Kosto-efektiviteti	5	1(5)	2(10)	5 (25)	4(20)	2(10)
Pikët		22	44	76	97	78

Përfundim

Opsioni 3 përfaqëson zgjidhjen më të mirë në aspektin e efektivitetit, kostos, shpejtësisë së zbatimit dhe përputhshmërisë me standardet e BE-së. Ai adreson në mënyrë të plotë problemet e identifikuara, pa krijuar barrë të panevojshme institucionale apo financiare, duke siguruar një reformë të qëndrueshme dhe të zbatueshme në praktikë.

Çështje të zbatimit

- *Shpjegoni se cila njësi do të jetë përgjegjëse për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
- *Shpjegoni pengesat e mundshme për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
- *Përshkruani masat që do të ndërmerren gjatë zbatimit për të arritur qëllimet e politikës.*
- *Specifikoni të gjitha kërkesat e përputhshmërisë dhe të zbatimit.*

Zbatimi i **Opsionit 3 (amendimi i ligjit ekzistues për biodiversitetin)** do të realizohet nga institucionet ekzistuese përgjegjëse për menaxhimin dhe mbrojtjen e biodiversitetit, konkretisht:

- **Ministria përgjegjëse për mjedisin** – institucioni kryesor për hartimin e politikave, koordinimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit;
- **Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM)** – përgjegjëse për monitorimin, mbledhjen dhe analizimin e të dhënave për biodiversitetin, si dhe raportimin;
- **Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM)** – përgjegjëse për administrimin dhe menaxhimin e zonave të mbrojtura dhe zbatimin e masave të ruajtjes;
- **Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore (NJVV)** – përgjegjëse për zbatimin në terren dhe integrimin e kërkesave të ligjit në planifikimin vendor;
- **Institucione të tjera kompetente** (inspektoratet, institucionet kërkimore dhe organet e kontrollit), sipas fushës së përgjegjësisë.

Gjatë zbatimit të opsionit të zgjedhur mund të shfaqen disa pengesa, si:

- Kapacitete të kufizuara teknike dhe njerëzore, veçanërisht për monitorim të avancuar të biodiversitetit;
- Mungesa e të dhënave të standardizuara dhe të integruara në nivel kombëtar;

- Koordinim jo gjithmonë efikas ndërinstitucional, sidomos ndërmjet nivelit qendror dhe vendor;
- Nevoja për përmirësim të infrastrukturës së informacionit dhe databazave mjedisore;
- Vonesa në miratimin e akteve nënligjore që do të detajojnë zbatimin praktik të ligjit;
- Rritja e kërkesave të BE-së për raportim, që mund të krijojë presion shtesë administrativ.

Për të siguruar arritjen e objektivave të politikës do të ndërmerren këto masa kryesore:

- Hartimi dhe miratimi i akteve nënligjore zbatuese brenda afateve të përcaktuara;

Akti nënligjor	Çfarë do të rregullojë
1 Akt për monitorimin dhe raportimin e biodiversitetit	Metodologjitë, periodicitetin, formatet e raportimit dhe përgjegjësitë institucionale
2 Akt për sistemin e të dhënave për biodiversitetin	Mbledhjen, administrimin, përditësimin dhe shkëmbimin e të dhënave
3 Akt për llojet jo vendase dhe invazive	Parandalimin, zbulimin e hershëm, monitorimin, kontrollin dhe menaxhimin
4 Akt për aksesin në burimet gjenetike dhe ndarjen e përfitimeve	Procedurat e autorizimit, përdorimit, kontrollit dhe ndarjes së përfitimeve
5 Akt për koordinimin institucional	Bashkëpunimin, shkëmbimin e informacionit dhe raportimin ndërinstitucional
6 Akt për masat e ruajtjes së habitateve dhe llojeve	Masat mbrojtëse për habitatet natyrore dhe llojet e egra

- Forcimi i sistemit kombëtar të monitorimit dhe raportimit të biodiversitetit;

Për arritjen e objektivit për forcimin e sistemit kombëtar të monitorimit dhe raportimit të biodiversitetit, do të ndërmerren masa për standardizimin e metodologjive të monitorimit, përcaktimin e treguesve dhe formateve të raportimit, përmirësimin e mbledhjes dhe shkëmbimit të të dhënave ndërmjet institucioneve, forcimin e koordinimit ndërinstitucional dhe zhvillimin e kapaciteteve teknike të strukturave përgjegjëse. Këto masa do të zbatohen nga institucionet ekzistuese, pa krijuar struktura të reja dhe pa kosto shtesë buxhetore.

- Krijimi dhe përmirësimi i bazave të të dhënave mjedisore dhe sistemit të informacionit; Për krijimin dhe përmirësimin e bazave të të dhënave mjedisore dhe sistemit të informacionit do të ndërmerren masa për inventarizimin e të dhënave ekzistuese, unifikimin e formateve të mbledhjes dhe raportimit, përcaktimin e institucioneve përgjegjëse për administrimin dhe përditësimin e të dhënave, si dhe përmirësimin e shkëmbimit të informacionit ndërmjet institucioneve. Të dhënat për habitatet, llojet, zonat e mbrojtura, llojet invazive dhe monitorimin e biodiversitetit do të integrohen gradualisht në sistemet ekzistuese të informacionit mjedisor. Këto masa do të realizohen nga strukturat ekzistuese, pa krijuar institucione të reja dhe pa kosto shtesë buxhetore.
- Trajnimi i stafit të institucioneve përgjegjëse për zbatimin e kërkesave të reja ligjore;
- Rritja e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe ndërsektorial;
- Forcimi i inspektimit dhe kontrollit në terren për zbatimin e masave të mbrojtjes; Për forcimin e inspektimit dhe kontrollit në terren do të ndërmerren masa për hartimin e planeve periodike të kontrollit bazuar në risk, përdorimin e të dhënave të monitorimit për orientimin e inspektimeve, unifikimin e praktikave të kontrollit dhe raportimit, forcimin e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve përgjegjëse për inspektimin dhe kontrallin, si dhe ndjekjen e zbatimit të masave mbrojtëse në terren. Këto masa do të

realizohen nga strukturat ekzistuese, pa krijuar struktura të reja dhe pa kosto shtesë buxhetore.

- Zhvillimi i procedurave për ABS (aksesin në burimet gjenetike dhe ndarjen e përfitimeve);
- Përmirësimi i mekanizmave për menaxhimin e llojeve invazive dhe jo vendase.

Zbatimi i ligjit të ndryshuar kërkon përmbushjen e këtyre kërkesave kryesore:

- **Përputhje e plotë me acquis të BE-së**, veçanërisht:
 - Direktivën 92/43/KEE (Habitatet natyrore);
 - Direktivën 2009/147/KE (Shpendët e egra);
 - Rregulloren (BE) nr. 511/2014 dhe Protokollin e Nagojës (ABS).
- **Zbatimi i standardeve të monitorimit dhe raportimit të BE-së**, përfshirë:
 - mbledhjen sistematike të të dhënave;
 - raportime periodike kombëtare dhe ndërkombëtare;
 - përdorimin e metodologjive të harmonizuara.
- **Zbatimi i kërkesave institucionale**, duke përfshirë:
 - ndarjen e qartë të përgjegjësi ndërmjet institucioneve;
 - koordinim efektiv ndërinstitucional;
 - forcim të rolit të inspektimit dhe kontrollit.
- **Zbatimi i kërkesave për ABS**, përfshirë:
 - krijimin e procedurave të autorizimit për akses në burimet gjenetike;
 - regjistrimin dhe monitorimin e përdoruesve;
 - sigurimin e ndarjes së drejtë dhe të barabartë të përfitimeve.
- **Përputhshmëri me kërkesat e transparencës dhe aksesit në informacion**, duke garantuar publikimin e të dhënave dhe pjesëmarrjen e palëve të interesit.

Në tërësi, zbatimi i suksesshëm i opsionit të zgjedhur varet nga forcimi i kapaciteteve institucionale, koordinimi efektiv dhe zhvillimi i një sistemi funksional monitorimi dhe raportimi në përputhje me standardet evropiane.

Faza e shqyrtimit/vlerësimit

- *Jepni një përshkrim të përmbledhur të masave të monitorimit dhe të vlerësimit.*
- *Identifikoni kriteret/treguesit për të matur arritjen e qëllimeve ose progresin drejt tyre.*

Monitorimi dhe vlerësimi i zbatimit të ndryshimeve në Ligjin për mbrojtjen e biodiversitetit do të realizohet në mënyrë të vazhdueshme dhe sistematike nga institucionet përgjegjëse, me koordinim qendror nga Ministria përgjegjëse për mjedisin.

Monitorimi dhe vlerësimi i zbatimit të ndryshimeve në ligjin për mbrojtjen e biodiversitetit do të realizohet në mënyrë të vazhdueshme nga institucionet përgjegjëse për mjedisin, biodiversitetin, zonat e mbrojtura, monitorimin mjedisor dhe kontrollin e zbatimit të legjislacionit. Koordinimi i përgjithshëm i procesit do të kryhet nga ministria përgjegjëse për mjedisin, e cila do të ndjekë zbatimin e kuadrit ligjor, do të koordinojë institucionet e varësisë dhe do të përgatisë raportimet përkatëse në kuadër të detyrimeve kombëtare dhe procesit të përafrimit me acquis të Bashkimit Evropian.

Mbledhja e të dhënave do të realizohet nga institucionet që ushtrojnë funksione monitorimi dhe administrimi në terren, përfshirë strukturat përgjegjëse për zonat e mbrojtura, agjencitë mjedisore dhe, sipas rastit, strukturat inspektuese. Këto institucione do të mbledhin informacion mbi gjendjen e habitateve dhe llojeve, presionet mbi biodiversitetin, zbatimin e masave mbrojtëse, përdorimin e burimeve gjenetike, rastet e evidentuara gjatë monitorimit dhe masat e ndërmarra për përputhshmëri.

Të dhënat e mbledhura në nivel terreni do të përcillen periodikisht pranë institucioneve përgjegjëse qendrore për analizim, konsolidim dhe raportim. Agjencitë përgjegjëse për monitorimin mjedisor dhe administrimin e zonave të mbrojtura do të analizojnë të dhënat teknike, do të evidentojnë problematikat kryesore dhe do t'i përcjellin ministrisë përgjegjëse për mjedisin informacionin e nevojshëm për vlerësimin e zbatimit të ligjit.

Raportimi do të organizohet në dy nivele:

1. **Raportim periodik institucional**, i cili do të kryhet nga institucionet zbatuese pranë ministrisë përgjegjëse për mjedisin, të paktën një herë në vit. Ky raportim do të përfshijë të dhëna mbi monitorimin e biodiversitetit, zbatimin e masave ligjore, problematikat e hasura, nevojat për përmirësim dhe rekomandimet për ndërhyrje të mëtejshme.
2. **Raportim tematik ose i posaçëm**, i cili mund të kryhet sa herë që kërkohet nga ministria përgjegjëse, në rastet kur evidentohen problematika të veçanta, nevoja për raportim në kuadër të procesit të integritetit evropian, ose kërkesa për informacion lidhur me zbatimin e *acquis* në fushën e biodiversitetit dhe ABS.

Ministria përgjegjëse për mjedisin do të jetë institucioni që konsolidon informacionin përfundimtar dhe vlerëson progresin në zbatimin e ndryshimeve ligjore. Ky vlerësim do të përdoret për raportimet periodike në kuadër të Kapitullit 27, për përditësimin e politikave kombëtare për biodiversitetin, për hartimin ose rishikimin e akteve nënligjore, si dhe për përmirësimin e praktikave të monitorimit dhe raportimit.

Procesi do të përfshijë:

1. Përafrimi i plotë me *acquis* të BE-së në fushën e biodiversitetit (afatmesëm)

- Harmonizimi i dispozitave kombëtare me Direktivën 92/43/KEE dhe Direktivën 2009/147/KE;
- Përmirësimi i rregullave për mbrojtjen e habitateve dhe llojeve;
- Forcimi i kërkesave për monitorim dhe raportim.

Indikator: rritja e përputhshmërisë ligjore dhe raportimet periodike sipas standardeve të BE-së.

2. Forcimi i sistemit kombëtar të monitorimit dhe raportimit të biodiversitetit (afatmesëm)

- Standardizimi i metodologjive të mbledhjes së të dhënave;
- Përmirësimi i sistemit të informacionit për biodiversitetin;
- Rritja e cilësisë dhe periodicitetit të raportimeve kombëtare dhe ndërkombëtare.

Indikator: numri i raporteve të prodhuara dhe përputhshmëria me kërkesat e BE-së.

Indikator: përmirësimi i mekanizmave të raportimit dhe koordinimit ndërinstitucional.

Objektivat synohen të arrihen në mënyrë progresive në periudhën afatshkurtër (1–2 vite) dhe afatmesme (3–5 vite) pas miratimit të ndryshimeve ligjore, me rezultate të qëndrueshme afatgjata në ruajtjen e biodiversitetit dhe përafrimin me BE

Për të matur arritjen e objektivave të politikës do të përdoren këta tregues kryesorë:

1. Tregues për monitorimin e biodiversitetit

- numri i habitateve të monitoruara rregullisht;
- numri i llojeve me interes për BE-në të përfshira në monitorim;

2. Tregues për raportimin

- numri i raporteve kombëtare dhe ndërkombëtare të dorëzuara në afat;
- përputhshmëria e raporteve me standardet e BE-së;
- frekuenca e përditësimit të të dhënave.

3. Tregues për mbrojtjen e habitateve dhe llojeve

- ndryshimi në statusin e ruajtjes së habitateve natyrore;
- trendi i popullatave të llojeve të mbrojtura;
- numri i rasteve të identifikuar dhe të menaxhuara të dëmtimeve ekologjike.

4. Tregues për menaxhimin e llojeve invazive
 - numri i rasteve të raportuara të llojeve invazive;
 - masat e ndërmarra për kontroll dhe eliminim;
 - reduktimi i përhapjes së tyre në kohë.
5. Tregues për sistemin ABS
 - numri i autorizimeve të dhëna për akses në burime gjenetike;
 - numri i marrëveshjeve për ndarjen e përfitimeve;
 - funksionimi i regjistrave dhe procedurave administrative për ABS.
6. Tregues institucionalë
 - shkalla e bashkëpunimit ndërinstitutional (raporte të përbashkëta, koordinim);
 - numri i inspektimeve dhe kontrolleve të realizuara;
 - kohëzgjatja e procesit të raportimit dhe vendimmarrjes.

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca2/a

Tabela: Vlera aktuale neto në total (VAN) - kostot dhe përfitimet me vlerë monetare të përcaktuar në milionë lekë e zbritur për 10 vjet (Vlera aktuale e kostos dhe vlera aktuale e përfitimit); krahasuar me status quo-në.

Shifrat në tabelë janë të shprehura në miliona (000) Lekë.

OPSIONI 3 i preferuar amendimi i ligjit “Për mbrotjen e Biodiversitetit” i ndryshuar:

	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Viti 6	Viti 7	Viti 8	Viti 9	Viti 10
Faktori zbritës	1.00000	0.952835	0.907894	0.865073	0.824271	0.785394	0.748351	0.713055	0.679423	0.647378
Kosto për buxhetin e NJVV – njëhere ((kosto per stafin per projektligjin-paga))	800	400	-	-	-	-	-	-	-	-
"Kosto për buxhetin – në vazhdim (kosto per monitorimin e faunes se eger nga AKM; kosto për stafin e pushtetit vendor (bashki) kosto per stafin e zonave te mbrojtura AdZM-paga)"	2,946	3,046	2,446	2,446	2,446	3,446	3,446	3,446	3,446	3,446
Kosto për biznesin – njëherë										
Kosto për biznesin – në vazhdim										
Kosto për grupet e tjera – njëherë										
Kosto për grupet e tjera – në vazhdim										
Kosto në total	3,746	3,446	2,446	2,446	2,446	3,446	3,446	3,446	3,446	3,446

Kosto e zbritur në total = Kosto në total x faktorin zbritës	3,746	3,283	2,221	2,116	2,016	2,706	2,579	2,457	2,341	2,231
Përfitimi për buxhetin – në vazhdim										
Përfitimi për buxhetin – në vazhdim										
Përfitimi për biznesin – njëherë										
Përfitimi për biznesin – në vazhdim										
Përfitimi për grupet e tjera – njëherë										
Përfitimi për grupet e tjera – në vazhdim (persona fizikë, OJF, subjekte private ose komunitete lokale që do të marrin financim)										
Përfitimi në total										
Përfitimi i zbritur në total = Përfitimi në total x faktorin zbritës	-									
Vlera aktuale e kostos në total	25,697									
Vlera aktuale e përfitimit në total	-									
Vlera aktuale neto (VAN) = Vlera aktuale e përfitimit në total – Vlera aktuale e kostos në total	(25,697)									

Tabelë: Vlera aktuale neto në total e çdo opsiioni			
Opsioni	Vlera aktuale në mijë lekë		Vlera aktuale neto në mijë lekë
	Kosto	Përfitimi	
Opsioni 1	25,697	-	-25,697
Opsioni 2	0	0	0

Perlllogaritja e kostove ne shtojcen 2/A lidhur me kostot e buxhetit ne vazhdim te analizuara paraqiten si ne table:										
Shifrat në tabelë janë të shprehura në mijë (000) Lekë										
	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Viti 6	Viti 7	Viti 8	Viti 9	Viti 10
Kosto per monitorimin e faunes se eger nga AKM;	1,000	1,100	500	500	500	1,500	1,500	1,500	1,500	1,500
Kosto për stafin e pushtetit vendor (bashki)	146	146	146	146	146	146	146	146	146	146

Kosto per stafin e zonave te mbrojtura AdZM-paga)	1,800	1,800	1,800	1,800	1,800	1,800	1,800	1,800	1,800	1,800
Totali	2,946	3,046	2,446	2,446	2,446	3,446	3,446	3,446	3,446	3,446

Kostot e paraqitura në tabelë përfaqësojnë kostot ekonomike të zbatimit të projektligjit dhe lidhen me monitorimin e biodiversitetit, kërkimin shkencor, administrimin e zonave të mbrojtura dhe angazhimin e institucioneve përgjegjëse. Këto kosto janë parashikuar të mbulohen brenda fondeve të miratuara në Programin Buxhetor Afatmesëm (PBA) dhe nuk kërkojnë fonde shtesë nga buxheti i shtetit. Përfitimet e projektligjit janë kryesisht mjedisore, institucionale dhe sociale dhe, për shkak të mungesës së një metodologjie të besueshme dhe të dhënave bazë, nuk janë monetizuar në këtë fazë të analizës.

Miratimi i projektligjit për biodiversitetin, ku përfitimet kryesore janë:

- ruajtja e habitateve;
- ruajtja e specieve;
- përmbushja e acquis të BE-së;
- shmangia e procedurave të shkeljes;
- përmirësimi i monitorimit;
- përmirësimi i menaxhimit të zonave të mbrojtura.

Këto **përfitime** janë **afatgjata dhe kryesisht jo të monetizueshme**

Stafi ekzistues kryen hartimin brenda funksioneve dhe pagave të miratuara. Monitorimi financohet nga programi ekzistues; amendimi nuk kërkon fond shtesë. Koordinimi kryhet nga stafi ekzistues, pa shtesë personeli ose fondi. Paga dhe veprimtaritë ekzistojnë edhe pa amendimin. Nuk është provuar rritje inkrementale e shkaktuar nga ndryshimi ligjor. Kostot administrative të mundshme për subjektet private nuk janë përfshirë me vlerë 0, por janë shënuar si të pamonetizuara dhe janë vlerësuar në mënyrë cilësore për shkak të mungesës së të dhënave të mjaftueshme për një përllogaritje të besueshme.

Përllogaritjet janë paraqitur mbi bazën e vlerave totale të kostove për periudhën 10-vjeçare.

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca2/b

Tabelë: Vlera aktuale neto në total e çdo opsioni.

Opsioni	Vlera aktuale në mijë lekë		Vlera aktuale neto në milionë lekë
	Kosto	Përfitimi	
Opsioni 0	Nuk është monetizuar	Nuk është monetizuar	Analizë cilësore
Opsioni 1	Nuk është monetizuar	Nuk është monetizuar	Analizë cilësore
Opsioni 2	Nuk është monetizuar	Nuk është monetizuar	Analizë cilësore
Opsioni 3	31760	274900	243,140
Opsioni 4	Nuk është monetizuar	Nuk është monetizuar	Analizë cilësore

